


# LAJMËTARI

## I BERATIT



Adresa: L. "30 Vjetori", tek stadiumi i vjetër  
Tel & Fax ++ 355 32 36 932  
Cel: 069 20 97 685

Viti III, Nr. 50 (125) E përjavshme e pavarur

E hënë, 30 janar 2006

Çmimi 20 lekë ( 1 Euro)

Adresa: Lagjja "Dëshmorët e Kombit", pranë shtypshkronjës "Lirsan Ekspres".

Tel: + 069 2247353

Adresa në internet: [www.lajmetari.net](http://www.lajmetari.net)

e-mail: [redaksia@lajmetari.net](mailto:redaksia@lajmetari.net)

### P O L I T I K Ë

## Shpallen kandidatët për kreun e PS-së Berat

Faqe 2

### E S E

Balil Gjini

## Shteti dhe kulti i rinimit të përjetshëm

Faqe 3

### L E T R A

Bujar Orizaj

## Kryesisë së degës PD Berat, Prefektit z. Roland Bejko

Faqe 6

### O P I N I O N

Fatos Lubonja

## A mjafton miti i "Tolerances fetare"

Faqe 10

### E D I T O R I A L

## Kur punët bëhen pa mend


Në Berat ka kohë që po shqepen trotuare, rrugica, sheshe dhe rrugë, Qyteti është kthyer në kantier pune. Hapen kanale e gropa dhe vendosen tuba me linjat e tensionit të lartë 20 mijë kilovolt. Eskavatorët dhe punëtorët me kazma dhe lopata e kanë kthyer qytetin në një katund të përbaltur kur bie shi dhe tërë pluhur në kohë të thatë, Thuhet se vendosja e kësaj linje tensioni do të zgjidhë mjaft probleme të furnizimit të banorëve me energji elektrike. Mrekulli! Po si do të bëhet me kanalet në mes të lagjes, në mes të rrugës, në mes të qytetit? Si do të bëhet me trotuarin nga Ura e Goricës deri te Dardha? Ky trotuar ka fare pak kohë që u shtrua i ri. U hodhën aty miliona e miliona lekë që dolën nga xhepat e qytetarëve Bashkia e Beratit para disa vitesh reklamoi në media plane zhvillimi deri në vitin 2015. Si ka mundësi që nuk paska parashikuar vendosjen e linjës elektrike pas 3 vitesh? U shtruan rrugë në qytet ku u hodhën qindra milionë dhe tani ato rrugë u shqepën sërish, A nuk mund të vendoseshin tubat paraprakisht sic ndodh kudo në botë? Kaq dritëshkurtër janë urbanistët tanë?

Nuk është hera e parë që në Berat shkatërrohet ajo cka u ndërtua me shumë mund e para. Të gjithë banorët janë dëshmitarë, kur ende pa u përruar një rrugë shqepet, sepse ujësjellësi do të mermetojë tubacionin e kalbur, ende pa kaluar qytetari i parë në një trotuar, ai shkatërrohet, sepse telekomi kishte harruar të fuste linjën e tij.

Me c'duket në këtë vend njeri i bie gozhdës e tjetri patkoit. Në fakt po të shohësh me kujdes në historinë tonë të trishtueshme (të më falin "heronjtë") vëren se nuk janë të rralla rastet kur atë që është ndërtuar me mund nga një palë e ka shkatërruar brenda ditës pala tjetër, Është mallkim apo mendjeshkurtësi?

A ka studime të pjesshme dhe tërësore për një qytet si Berati? Nëse ka mos vallë bëhen investime pa përfillur këto studime? A do t'i shkojë nëpër mend ndonjë këshilltari bashkie për të propozuar një komision hetimor nga parlamenti i qytetit për të hetuar se si hidhen paratë e qytetarëve në vrimat e zeza të padijes apo të korrupsionit? Qytetarët shohin me habi se si shqepen trotuarë, rrugë e rrugica. Askush nuk del në media dhe t'u shpjegojë atyre pse ndodh e përsëritet kjo dukuri. Ndaj, kur shohin atë që me mund e para u ndërtua dhe po, prishet sot mërmërisin: "E kemi mallkim nga ..."

Y. Hima



Kanali i hapur në qendër të Beratit

Abedin Kaja

## PERSONALITETE TË SHKENCËS DHE KULTURËS NË KRT-në E BERATIT

Faqe 4

## Shtëpia-muze kthehet në haur për kafshët

Faqe 4

## Ndërtimet pa leje pushtojnë tokat bujqësore

Faqe 2

## Pegas 2005-2006

Faqe 8

## Rrëfenja

nga Agim Mehqemeja, Namik Selmani.

Faqe14

## Faqja sportive

nga Vlash Pambuku

Faqe15-16

## Shtëpia e Bojërave ICRO COATINGS

Bojëra, plastiko, hidromat, pigmente etj...


Tel: 37 290.

[icro.it](http://www.icro.it)

Pranë postës

## Si mund të mbroni automjetet tuaja?

TEXACO



ë ndryshme

LDOM

këmbimi me porosi për auto


sa:

arku i Urës Vajgu  
allë Western Unic


## Përdorni vajra të cilësisë së lartë

## KËTU DO TË GJENI me shumicë dhe pakicë:

Shell




FILTRA



ënda (eskavator, fadrom,

inistrator: Edisc  
el: 0682235888;



ë cilësisë  
lartë

amion, etj)

eshi

2

## Shpallen kandidatët për kryetarë të degës së Partisë Socialiste në Berat (qytet)

Ditën e premte më datën 27 janar 2006 kryesia e selisë rozë në Tiranë përzgjodhi kandidatët për kryetarë të degës së Partisë Socialiste në Berat (qytet).

Në datën 4 shkurt do të votohet për të zgjedhur kryetarin e PS-së së Beratit.


**Kandidaturat janë:**

1. Selman Hodaj, drejtor i shkollës së mesme të përgjithshme "Kristaq Capo".

2. Aleksandër Bode, drejtor i filialit të Telekomit.

3. Mensur Hoxha, drejtor i Sigurimeve Shoqërore në Berat.

Bie në sy kandidatura e Selman Hodajt, drejtor i SHMP "K.Capó", politikan i ri dhe i



pakonsumuar gjatë pushtetit 8-vjeçar të PS-së.


Burimet thonë se Hodaj ka mbështetjen e kryesisë së selisë rozë dhe posaçërisht të kryetarit të PS-së Edi Rama.

Lajmëtar

## NDERROHEN KRERËT E POLICISË

Me zvendesimin e djeshëm të zvdrejtorit dhe tri shefave të komisariatit në tri qytetet Berat, Kuçovë dhe Skrapar merr fund reforma për krerët e policisë në drejtorinë e policisë së qarkut Berat. Për zvendësimin e tyre, është zhvilluar një takim në sallën e mbledhjeve me kuadro të policisë së kësaj drejtorie. Krahas drejtorit të policisë së qarkut, z. Rehani Jahupi, në këtë takim morrte pjesë edhe zv. drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, k/komisar Ahmet Haxhia.


Z. Haxhia, pasi vlerësoi punën e mirë të zv. drejtorit të policisë së qarkut dhe ish-krerëve të policisë Berat, Kuçovë dhe Skrapar, bëri prezantimin e tyre. Zv. drejtor i policisë së qarkut u emërua n/komisar Halit Murataj në vend të n/komisar Kristaq Gjika i cili kalon në detyrën e shefit të anti-krimit ekonomik në Dibër. Në vend të n/komisar Luan Hysenji, i cili kalon shef i krimeve të hapura në drejtorinë e policisë së qarkut Berat, shef i komisariatit të policisë së rrethit të Beratit u emërua n/komisar Nikolla Vatnika i rikthyer në polici. Në Kuçovë



në vend të Behar Biberaj, i cili shkon specialist kundër krimit ekonomik në drejtorinë e policisë Tiranë, u emërua k/inspektor Mehmet Rrapo, i cili rikthehet në policinë e shtetit. Në qytetin e Skraparit në vend të Artan Hoxhës, i cili kalon specialist në drejtorinë e policisë Berat, u emërua k/inspektor Kudret Strumi. Me lëvizjet e ditës së djeshme merr fund reforma për krerët e policisë në qarkun e Beratit.

## NDERTIMET PA LEJE PUSHTOJNË TOKAT BUJQESORE

- Në shkallë qarku janë 2183 ndërtime pa leje në tokë bujqësore
- Del jashtë funksioni argjinatura dhe kanali kryesorë
- Vetëm në rrethin e Beratit janë 1449 ndërtime të tilla



Lëvizja e popullsisë nga zonat malore drejt atyre rurale dhe urbane gjatë 15 viteve të fundit si dhe vendosja e tyre në mënyrë kaotike dhe pa asnjë studim konkret urbanistik, kanë sjellë një zhvillim demografik të pakontrolluar në qarkun e Beratit. Shumë prej të ardhurve nga këto zona i kanë ndërtuar shtëpitë e tyre pa asnjë studim urbanistik duke pushtuar kështu hektarë të tërë të tokës bujqësore në fushë, ndërkohë që këto ndërtime po të ishin bërë mbi bazën e një studimi urbanistik farë mirë mund të ndërtoheshin në pjesët kodrinore të këtyre sipër-faqeve të tokës bujqësore. Në shkallë qarku deri tani janë funksionale 53036 ha tokë bujqësore në 25 njësitë vendore të qarkut. Sipas shefit të seksionit të administrimit dhe të mbrojtjes të tokës në qarkun e Beratit, z. Hajredin Lybeshari, mbi tokat bujqësore janë 2183 objekte ndërtimi pa leje të identifikuar deri tani, të cilat kanë pushtuar 59.2 ha tokë

bujqësore. Beratit ka rreth 35.437 ha tokë bujqësore ose 37% të tokës gjithsej në shkallë qarku, ku 33% janë në zonën urbane dhe 65% në zonën malore. Vetëm në rrethin e Beratit, i cili është edhe më i dëmtuari, janë 1449 ndërtime pa leje në tokë bujqësore që kanë zënë 49.7 ha tokë bujqësore funksionale. Zonat më të prekura nga këto ndërtime janë komunat Poshnjë, Otlak, Velabisht, rajoni Uznovë, si dhe Perondi dhe Kozare të rrethit të Kuçovës, ku, sipas z. Lybeshari, është bërë një masakër e vërtetë urbane. Ndërtimet pa leje gjithashtu kanë zaptuar edhe argjinaturën dhe kanalën kryesor nga ish-kombinati deri në qendër të fshatit Poshnjë. "Një pjesë e mirë e këtyre ndërtimeve janë bërë mbi argjinaturën e kanalit në të dy krahët e tij dhe për këtë presim ndërhyrjen e strukturave përkatëse për të venë në efikasitet këto objekt kaq të rëndësishëm", shprehet për gazeta shefi i seksionit të

administrimit dhe të mbrojtjes të tokës në qarkun e Beratit, z. Hajredin Lybeshari. Më poshtë z. Lybeshari është shprehur: "Detyra jonë është që t'i evidentojmë dhe t'i paraqesim këto ndërtime në strukturat përkatëse që kanë detyrimin ligjor për të ndërhyrë, siç janë prefektura, drejtorja e menaxhimit të tokës apo drejtorja e bujqësisë në shkallë qarku, si dhe Ministria e Ndërtimit dhe Transportit dhe Telekomunikacionit. Ne e kemi bërë prezent këtë shqetësim në këto institucione dhe tani presim reagimin e tyre. Këtu nuk e kemi fjalën për të prishur të gjitha këto ndërtime, por për atje ku ato bëhen pengesë për funksionimin e kanalit kryesor apo në tokat bujqësore ku janë zënë sheshe ndërtimi jo sipas kritereve që ka ligji urban. Kemi konstatuar se në kundërshtim me ligjin janë dhënë sheshe ndërtimi 500-1000 m2, sipërfaqe, të cilat nuk ka arsye që të jepen në këtë sasi toke. Ne kërkojmë që të zbatohet ligji urban për të

## BERATI TRONDITET SËRISH NGA KRIMI NË FAMILJE

*Gruaja 60-vjeçare vret dhe masakron me sopatë burrin e saj 66-vjeçar*


*Ende pa u mbyllur muaji janar dhuna në familje shënon rastin e dytë të krimit makabër në rrethin e Beratit, pas atij të ndodhur në datë 07.01.06 në lagjen "Kushtrim" kur dhëndëri vrau ish-vjehrrin me dy plumba në gjoks. Këtë radhë ngjarja është zhvendosur në fshatin Pobrat, komuna Kutalli. Ngjarja makabër ka ndodhur rreth orës 20:30 në familjen Xhafa mes çiftit të moshuar të fshatit Pobrat. Bashkëshortët Fatime Xhafa 60-vjeç lindur në fshatin Metoh, Mallakastër, dhe banuese në fshatin Pobrat dhe Meçan Xhafa vjeç 66 lindur dhe banues në fshatin Pobrat, kishin disa vite që jetonin të dy bashkë pasi të katër fëmijët e tyre djem punonin si emigrantë në shtetin Grek. Sipas dëshmisë së Fatimes në organin e policisë, bashkëshorti i saj 66-vjeçar Meçani kishte kohë që pinte dhe nën efektin e alkoolit e dhunonte sistematikisht atë. Sipas saj edhe herë të tjera ajo kishte provuar fyerjet dhe dhunën fizike të bashkëshortit të saj. Kjo dhunë ka kulmuar rreth orës 20:30 kur Fatimeja e ka vvarë bashkëshortin e saj Meçanin me sopatë.*

### Ngjarja:

Rreth orës 20:30 Meçani ka shkuar në shtëpi i dehur dhe pasi ka hyrë në kuzhinë, e cila ndodhet e veçuar nga banesa, ka gjetur aty bashkëshortin e tij Fatimen dhe menjëherë ka filluar ta shajë, fyejë dhe dhunojë atë. Më pas Meçani është shtrirë në njërin prej divanëve të kuzhinës dhe në momentin që ai ka qenë i kapitur për shkak të alkoolit, Fatimeja ka marrë sopatën e druve dhe në fillim e ka qëlluar atë prapa kokës me pjesën e prapme të sopatës. Në gjendje depresioni ajo ka menduar që më pas t'i presë atij edhe dorën e djathtë nga frika se mos ai do të ngrihej përsëri dhe do ta dhunonte. Pas kësaj ajo ka vazhduar duke i prerë bashkëshortit të saj edhe kokën në pjesën e fytyrës si dhe duke e goditur edhe në pjesët e tjera të trupit. Pas aktit makabër Fatimeja ka njoftuar në telefon njërin nga vëllezërit e saj në qytetin e Patosit të cilit i ka thënë se kishte vvarë bashkëshortin e saj. Pas njoftimit të marrë prej saj në fshatin Pobrat kanë mbërritur vëllezërit e Fatimes, të cilët kanë njoftuar menjëherë në komisariatin e policisë Berat.

### Policia:

Pas marrjes së njoftimit në drejtim të fshatit Pobrat kanë mbërritur forcat e policisë dhe një grup ekspertësh të policisë kriminale, të cilët kanë bërë kqyrjen e vendit të ngjarjes dhe kanë arrestuar në flagrancë vrasësen e bashkëshortit të saj, si dhe kanë sekuestruar në cilësinë e provës materiale sopatën me të cilën ajo kishte kryer krimin. Ndërsa trupi i pajetë i viktimës ka shkuar në morgun e spitalit për t'iu nënshtruar ekspertizës mjeko-ligjore, 60-vjeçarja është shoqëruar për në ambjentet e komisariatit të policisë. Përpara oficerëve të policisë gjyqësore Fatimeja e ka pranuar krimin duke u



shprehur se e kishte vvarë bashkëshortin e saj, pasi ai kishte vite që e dhunonte sistematikisht dhe se në këtë moshë ajo ka preferuar që më mirë të jetojë në qelitë e burgut se sa të vazhdonte vuajtjen pa fund të shkaktuar nga bashkëshorti i saj, Meçani. Më pas grupi hetimor ka përpiluar dosjen dhe e ka dërguar atë për prokurorinë e rrethit për hetime të mëtejshme.

### Precedenti:

Thuajse e njëjta ngjarje ku për shkak të dhunës në familje gruaja vret burrin e saj, ka ndodhur në 14.06.05 në lagjen "30-vjetori" në Berat. 32-vjeçarja Edlira Bazonja, pasi kishte provuar në mënyrë sistematike dhunën e ushtruar nga bashkëshorti i saj Rakip Bazonja, i cili gjithashtu shkonte i dehur në shtëpi, Edlira ka marrë një thikë dhe e ka qëlluar disa herë mbas shpine bashkëshortin e saj Rakipin, i cili për shkak të plagëve të marra ka gjetur vdekjen e menjëhershme. Tashme 32-vjeçarja Edlira Bazonja ndodhet në qelitë e burgut të grave në qytetin e Tiranës për të vuajtur dënimin e krimit të vrasjes, krim të cilin e ka kryer ndaj bashkëshortit të vet për shkak të pamundësisë për të përballuar dhunën që ai ushtronte ndaj saj.

*Përgatiti kronikat Abedin Kaja*

-1-

Njerëz të fuqishëm të këtij vendi, të majtë qofshin, a të djathtë, të bardhë, a të zinj, i kanë dhënë dum që atë substancë të zezë me të cilën është mbrujtur qenësia e shtetit, ta trajtojnë e ta kullandrisin me kollajxhenë e një cope argjile të zezë, duke e vërtitur sa nga njëra dorë në tjetrën, duke i dhënë forma e trajta argalisëse, të buta, eh, shumë të buta, siç i vjen për hosh shpirtit të tyre, sepse, siç thotë Borgesi, pavetëdijshëm e dinë se eksistenca e tyre pas vdekjes s' mund të jetë veç transmigrim dhe shpërngulje kujtese në veprat që kanë bërë.

Në të gjitha këto gjeeste lazdruese e ëmbëlcake ndihen fare qashtër duart delikate të Elektrës, e cila, e vendosur pas shpinës së të jatit, i heq nga jaka e xhaketës thërmizat e zbokthit dhe iu jep një krehër flokëve të tij të zbardhur nga koha. Pastaj i buzëqesh, i shtyp majën e hundës me gisht dhe largohet sërish në katakombet e historisë. Pra, gjithë këtë mesele mund ta kundrojmë dhe si një dashuri të sublimuar, ose si kompleksin e Elektrës.

-2-

Kulti i rinimit është ajo gjallesa grimurmë që ngarend pa pra brenda korridoreve të gjakut të njeriut. Çalltisja e pranverës në shumë katunde ende festohet sipas një rituali pagan. Nëpër duar vihen verdhëza, në dyert e shtëpive vihen thana, apo thërpele të gjelbëra, nëpër murishtet e vjetra tunden zilet e këmborët për të dëbuar gjarpërinjtë, amvisat sherbetosin muret me gëlqere. Gjithçka është gati për t' ia marrë këngës. A mos vallë dëshira për reformim të shtetit sa herë ai ndërron duar, është një simetri hileqare e natyrës, një dritare e rreme e vizatuar mbi oxhak?

Rob i veseve dhe obsesioneve të veta, njeriu, duke kundruar përjetësinë e natyrës, ka gjakuar (pse jo) dhe përjetësinë e vetes. Le të ndërmendim heroin e epit të parë, Gilgameshin. Heroi homonin kur merr vesh se nuk është i përjetshëm në këtë botë, se do të vijë çasti që një e treta e vdekshme, do të fitojë ndaj dy të tretave të pavdekshme, bëhet si i ndërkryer. Ai i turret demit hyjnor, i shkul nga shalët rrepën seksuale dhe ia vërtit në surrat perëndeshës hirplotë. I shtare, dhe, pas këtij gjesti, siç mund të kuptohet fare lehtë, vajti njëherë e mirë nderi e namuzi në botë.


(Këtu mbase është rasti të shkoqitim se ashtu si ne, edhe Zoti nuk duhet të ketë pasur ndonjë mendim shumë të mirë për heronjtë, Akilin, Atlantin, Herkulin, etj, dhe i ka trajtuar ashtu siç ishin në të vërtetë: dobiçë e bashto perëndish, të lindur nga martesat jolegale.)

-3-

A mund të kundrohet shteti brenda alternativës "Ose,... ose"? Pra, ose: i ngurtë, statik, me mure të zyrtë kështjellash, ose: levarash, i hapur damalla, me çurgime ujvarash

# Shteti dhe kulti i rinimit të përjetshëm

Balil Gjini



Gjithë jeta e njerëzimit është një ulërimë ekzistenciale në brinjët e zhveshura së cilës shihen njerëz që përmes magjive, pëshpirtjeve, medimeve, kërkojnë barin e përjetësisë, eleksirin e dashurisë; Elisabeth Bathori, princesha famëzë austriake, bënte banjo me gjakun e grave të vrara, me shpresën se gjaku i tyre, i thithur përmes poreve të trupit, do t' i ripërtërinte qelizat e rezbitura.

në fasadat e qelqta. Njëherë kur shteti u kundrua si një lodër fëmijësh me shirita të kuq e të bardhë dhe me kureshtjen e fëmijëve u orvatën t' i hiqnin ingranazhet, njëhopshëm u vërejt se ajo ishte një bombë e rrezikshme dhe iu shpërtheu në duar duke bërë hatanë. Ishte viti 1997.

Na duket e tepërt rrekja për ta paraqitur qenien që do të bëjë reformimin, medemek nëpunësin e shtetit, si krijues e novator, cilësi këto që i janë marrë hua artit e shkenceve dhe lypset t' ju kthehen prapë leksikut të tyre. Nëpunësit të shtetit i mjafton të jetë i rregullt, korrekt, dhe, ashtu siç thotë Kafka, të jetë roja në portat e ligjit. Anipse kësioji ai mund të shëmbëllejë paksa humbamento, si nëpunësat e Çehovit. Puna ndryshon po t' i ketë rënë në hise të jetë bistak i Likurgut, Solomonit, apo Perikliut.

-4-

Është brenda prirjes së njeriut uria e panginjur ndaj gjërave të freskëta e taze. Sa më shumë jetoset aq më shumë priret për gjallërimin e qelizave të mplakura. E gjejmë këtë në jetën e patriarkëve biblikë, perandorëve, mbretërve. Njëmijë konkubina e të dashura mbante në oborr vetë mbreti Solomon, kurse Xhingis Khani "engedisej" me rreth pesëqind sosh.

Gjithë jeta e njerëzimit është një ulërimë ekzistenciale në brinjët

e zhveshura së cilës shihen njerëz që përmes magjive, pëshpirtjeve, medimeve, kërkojnë barin e përjetësisë, eleksirin e dashurisë; Elisabeth Bathori, princesha famëzë austriake, bënte banjo me gjakun e grave të vrara, me shpresën se gjaku i tyre, i thithur përmes poreve të trupit, do t' i ripërtërinte qelizat e rezbitura.

Vetë dashuria e gjyshërve ndaj nipërve e mbesave, po t' i heqësh atë cipë të hollë vishtulloziteti patetik, është edhe disi e filligësht (kujtoni skicën e Baudeauler-it "Plaka"). Si në kohën e Diktaturës, si tani, tek ne flitet vazhdimisht për talente të rinj, për gjenij të vegjël, për pritjen e shpëtimtarit dhe të Mesisë. Është frika e kombit plak nga vdekja, të cilën rreket ta trembë duket tundur si flamuj kurbane fëmijësh (arketipi i tjetërsuar i zileve dhe këmborëve tek festa pagane). Hitlerit në ditëlindje i binin në sini emrat e pesëqind mijë vajzave e djemve njëmbëdhjetë vjeçarë, kurse Enveri në ditëlindjen e vet kërkonte t' i mbushte rradhët me gjak të freskët të ri. Vini re edhe një herë terminologjinë: gjak i freskët, i ri.

Të dy kryeministrat, si Nano, si Berisha, u rrethuan nga djelmoha të rinj. Shpresoj që kjo të ftillohet si një puls pas firasjes së shtetit (diktaturës), sesa si një flijues zanafillor.

Orvatja për ndryshimin e vazhdueshëm të shtetit është orvatja për shkulljen e dhëmbëve të Leviathanit, përbindëshit biblik të Jobit, metaforën e të cilit Hobsi e përdor për librin e tij. "Levathianin a e ze me grep?/ Vallë me toja ia lidh dot gjuhën?"... thuhet në Bibël. Në mos qoftë kështu është gjakimi për ta parë të zbutur, jo lubi a krokodil të ububushëm, por zhapik argalisës murishtesh të vjetra. Si pasojë e kësaj ne kemi patur vazhdimisht një shtet surbullirë, të pangjizur, dhe, si të tillë, të pamundur ta kuptosh, sepse s' ka kode për të interpretuar kaosin.

Shtetin tonë ne mund ta përfaqsim me një shtyllë elektrike në galixhanet e së cilës janë përtëleksur e bërë kokolësh me dhjetra fije e tela; e sikur të mos mjaftonte kjo, na dhe tjetra, po deshe: i zoti e përdor pjesën e drunj të të shtyllës si mullar bari për dimër. Kanalet e tij janë të bllokuara si tranшетë e zboveve ushtarake nga balta. Kjo gjendje izolimi mund të kundrohet fare mirë tek kultura shqiptare, e cila, e paafte të dalë nga gjendja e kapsllëkut, ia ka dalë mbanë që përmes klizmave të sforcuara t' ia plasë diareve rapsodike në faqet e gazetave shqiptare.

-6-

Orvatja për reformim e ndryshim mund të jetë dhe shestimi për të ajgëtuat tek thelbi i shtetit jo tabutë e frikshme: farërat e fantazmave (ligji, polici, burgu), apo bitumin e valë të çdo imazhi skematik të skëterrës, por diçka tjetër më të ëmbël. A mos vallë kjo është një prirje uviversale, që thelbin barbar të gjërave rreket ta veshë me guaska të qelqta e farfuritëse?

Vini re një nga institucionet e modernitetit: bankën. Brenda saj janë kasafortat, bunkerët, munxat e kyçet (ku ruhen paratë), kurse jashtë janë qelqet, xhamet e farfuritë. Në metamorfozën e përbindëshit ka ndryshuar thelbi i tij: rropullitë janë bërë zhguallërore, kurse zhgualli është bërë i butë. A thua thelbin barbar ai e ka rrufullitur brenda vetes për ta tretur e shkatërruar më lehtë? Është arketipi model ku është shartuar barbarja me të qytetëruarën.

Kulti i rinimit të vazhdueshëm ka të bëjë me shpresën se një ditë qivuri i varrit do të shndërrohet në njeri, do të hapë buzët e gurta dhe të shqiptojë fjalën mister që ka miliona vjet që pritët: ka, apo s' ka gjë, andej, Përmatanë. E gjersa të ndodhë kjo, përgjigja na vjen nga krijimi i i parë i njerëzimit "Epi i Gilgameshit". "Në detin me ujë të ëmbël ai bar rritet? Sak sa një therrë drize bari është....", thuhet tek aty. Deti me ujë të ëmbël?! Sigurisht është një metaforë, një metaforë që nënkupton plaçentën nënësore. Kthimi tek ajo është gjasa e rikthimit edhe njëherë në fëmijë, kurse ngjirat rrotulluese të ciklit të ripërtëritjes, në fakt, s' janë tjetër veçse rrufullat rruftitëse të vdekjes...

## PERSONALITETE TË SHKENCËS DHE KULTURËS NË KRT-në E

## BERATIT

Në kuadrin e lëvizjeve që kanë përfshirë prefekturën e qarkut me qëllim krijimin e vlerave positive prefekti i qarkut z. Roland Bejko në bazë të nenit 17 të ligjit për KRT-në ka propozuar emrat e rinj që do të përfaqësojnë institucionin e prefektit në KRT-në e Beratit. Në këtë propozim të prefektit të qarkut janë dy specialistë urbanistë dhe arkitektë e një specialist konstruktor dhe një inxhinier ndërtimi. Katër emrat e rinj do të zëvendësojnë katër emrat e propozuar nga prefekti paraardhës të cilët kanë qenë Kostandin Dino, inxhinier hidro, Tahir Hysi inxhinier hidro, Rajmonda Kurti, arkitekte dhe Agim Nova inxhinier

hidro. Në një konferencë për shtyp lidhur me këtë problem prefekti i qarkut z.Bejko është shprehur: “Dua t’i falenderoj për punën e mjaftueshme, por jo të mirë dhe për kontributin e mjaftueshëm që kanë dhënë në KRT përfaqësuesit e mëparshëm të prefekturës”. Duke synuar gjithmonë më të mirën dhe duke vënë objektiva konkrete si dhe në kuadrin e të gjitha reformave që janë ndërmarrë në qeverisje, prefekti i qarkut z. Bejko ka propozuar katër emra të rinj që do të përfaqësojnë prefektin në KRT, emra që sipas z.Bejko nuk kanë konflikte interesi. Këta emra janë: Dr. Prof. Aleksandër Meksi, inxhinier arkitekt

Dr.Prof. Emin Riza, inxhinier, aktualisht specialist në Institutin e Monumenteve të Kulturës, Dr.Prof. Apollon Baçe, drejtor i IMK, znjsh.Marsela Plyku, arkitekte urbane,specialiste në IMK ka mbaruar studimet shkëlqyeshëm në Turqi (beratase). Të katër këta personalitete të njohur në fushat e tyre flasin shtatë gjuhë të huaja përveç kontributeve dhe vlerave intelektuale që njihen në të gjithë vendin. Motivi i këtyre propozimeve të reja sipas z. Bejko ka qënë fakti se qyteti i Beratit është një qytet mbi 2400-vjeçar në vazhdimësinë e tij dhe ky qytet së


shpejti do të bëhet pjesë e trashgimisë botërore. Më poshtë z. Bejko tha “Jam i bindur që Berati tashmë nuk do të jetë më qytet vetëm i beratasve por i shqiptarëve dhe qytet ballkanik tani ai do të jetë një qytet me pasuri botërore, ashtu siç edhe e meriton. Detyra jonë është që ta mbrojmë këtë trashëgimi të shkëlqyer që na kanë lënë të parët dhe të kontribuojmë që brezave t’u lëmë një qytet modern, ku të harmonizohet kultura e vjetër dhe ajo moderne. Këtë synon edhe ndryshimi i ri në KRT-në e prefekturës dhe për këtë unë falenderoj personalitetet që pranuan të jenë pjesë e KRT-së së qytetit të Beratit.

A.K.

## Shtëpia-muze kthehet në haur për kafshët

Shtëpia-muze ndodhet në krye të fshatit Roshnik në pjesën lindore të tij. Ajo është ndërtuar 300 vjet më parë, pra, në vitin 1700 nga Servet Brahimaj. Kjo shtëpi dy katëshe është një nga vlerat e rralla të zonës së Roshnikut dhe renditet ndër shtëpitë më me vlera në Berat. Shtëpia karakteristike me çardak ka qenë një ndër dallëndyshet e para e shkëputur nga shtëpitë karakteristike Beratase e cila shtegtoi dhe u vendos në Roshnik, fshat i cili në atë periudhë kohe ka qenë një ndër zonat më me zë të nahies së Beratit. Shtëpia është ndërtuar me kujdes, muret e saj edhe sot janë shumë të rregullt dhe të qendrueshëm.


“Pasi kishte bërë disa napolona flori në shtetin turk, Serveti, kishte vendosur që me një pjesë të ketij floriri të siguruar nga puna në Turqi, të ndertonte një palë sahraje në fshatin e vetë dhe si model ai kishte zgjedhur shtëpitë karakteristike me çardhak të qytetit të Beratit”, -shprehet njëri prej pleqve të fshatit. Po kështu sipas rrefimit të fshatarëve për të ndërtuar këtë shtëpi që tashmë i ka kaluar 300 vjet kanë punuar 40 çekan, 40 argatë dhe 40 mushka. Gurët e kësaj shtëpie janë të gjithë të zgjedhur dhe të skalitur hijshëm. Në vitin 1943 në këtë shtëpi nga data 6-9 shkurt është zhvilluar mbledhja për të zgjedhur Komitetin e PKSH për qarkun e Beratit dhe në përkujtim të kësaj ngjarjeje historike të kohës, në pjesën e jashtme të murit të saj është vendosur edhe një pllakadë që përkujton këtë ngjarje të LANÇ-it. “Po këtu është është formuar Komiteti i PKSH-së për qarkun e Beratit, por nuk mendoj se ky është shkaku i lënies në harresë dhe i braktisjes së kësaj shtëpie karakteristike, pasi aty mund të ishte formuar edhe Komiteti i Ballit Kombëtar apo largqoftë kjo shtëpi mund të kishte shërbyer edhe si kamp internimi dhe prapë duhej të ruhej si pjesë e historisë sonë pa futur këtu vlerat e rralla kulturore dhe arkitektonike të saj”, shprehet banori i ketij fshati, agronomi Beqir Fiska. Por vlera më e madhe e kësaj shtëpie qendron te koha kur ajo është ndërtuar, akitektura dhe vlerat e rralla artistike që ajo mbart në vetëvete. Deri në vitet '80 edhe pse kjo ishte një nga shtëpitë-muze të qarkut të Beratit, aty banonin trashëgimtarët e ndertuesit e saj Servet Brahimaj, pra, nipërit dhe mbesat e tij. Në vitet '80 duke parë vlerat historike, kulturore dhe muzeale të kësaj shtëpie, shteti i asaj kohe këtë shtëpi e mori në ruajtje dhe fisit Brahimaj i ndërtojti një shtëpi të re po në fshatin Roshnik. Deri në vitin 1990 në këtë shtëpi ruheshin disa prej vlerave dhe dokumenteve që flisnin për historikun e fshatit dhe të zonës së Roshnikut. Pas viteve '90 si shumë vlera të tjera edhe kjo ndërtesë u la në meshirë të fatit. Meqenëse shteti e braktisi këtë shtëpi-muze, atë e morën në ruajtje trashëgimtarët e saj, të cilët e kanë edhe sot, por duke i ndryshuar funksionin. Ajo sot përdoret si haur për të mbyllur kafshët dhe si depo ushqimi për këto kafshë. Kryetari i komunës Roshnik



z.Adriatik Serani shprehet “Kjo shtëpi e rrallë për nga vlerat edhe pse e braktisur nga shteti dhe institucionet e tijë falë marrjes në ruajtje nga ish-pronarët e saj është në gjendje të mirë dhe me një investim për të cilin krahas orga-nizmave shtetërore përkatëse jemi gati të kontribuojmë edhe ne si komunë që ajo të kthehet në identitet. Ne jemi të ineresuar që kjo shtëpi të rimerret në mbrojtje nga shteti, pasi ajo flet për historinë dhe trashëgiminë kulturore të fshatit tonë. Por për të bërë këtë kërkohet në radhë të parë angazhim nga punonjësit e muzeut historik në Berat dhe rifutjen e ketij objekti në inventarin e këti institucioni”, përfundon z.Serani. E pyetur për mundësinë e marrjes në ruajtje, riparimin dhe meremetimin e ketij muzeu, përgjegjesja e muzeut historik z.Marela Guga, shprehet se nuk e kemi në inventar këtë shtëpi-muze që ju thoni dhe se nuk e dimë se ka një të tillë në Roshnik. Unë kam në inventar muzeun historik të Sinjës, por jo atë të Roshnikut”.

A.K.

## Sekserët , apo mblesësit e këshillit të qarkut



Qerim Hysenbegasi

Të tillë ka kudo, me bollëk, bile dhe në këshillin e qarkut Berat. Lajmësi thonë, o ta hap, o ta mbyll derën me nusen që të servir; ndërsa sekserët, këta lajmësa të ditëve tona, ta mbyllin derën me reze të hekurt e me një dryn të madh mbi të. Për të mos folur në përgjithësi, po citoj formën arbitrarë të sekserëve të qarkut.

Këta zotërinj, Aristotel Telhaj, shef finance dhe Tahir Hysi, si kanë injoruar plotësisht familjarët e familjes Vrioni, kanë zhvatur në mes të ditës, pa iu dridhur fare qerpiku, pronën prej 1900 m2 në këmbët e Urës Vajgurore.

Kanë gjetur edhe dhëndërrin nevojtar, z.Bardhyl Ruci. Si kanë bërë “formalitetet” “zyrtarë”, ia kanë shitur nusen 1900 m2

dhëndërrushit të djegur. Kjo në këmbim të një shume prej 912000 lekësh. Duke pohuar se ky truall është pa pronar. Për këtë truall familjarët kanë depozituar pranë KKKP këto dokumenta:

- 1.Tapinë e arës “Menca” 10 dynymëshe.
- 2.Vendimin e KKKP me 7 firma.
- 3.Vendimin e gjykatës për kthimin e sipërfaqes së lirë, por asgjë.

Nuk di ç’duhej paraqitur pranë këshillit të qarkut që të mos shitej kjo pronë?!

Këtë le të na e sqarojnë në gjyq zotërinjtë e qarkut. Pretendimi i tyre , bajat. Kjo sipërfaqe s’është e hipotekuar. Nga ka dalë tapia e familjarëve s’është bërë hipotekimi i ri, por kjo s’u lë dorë të lirë z. të qarkut që t’u shesin apo të bëjnë si të duan. Në lagjen “Barrikadë” “Ara e Kullaut” janë mjaft shtëpi të pahipotekuara. Ju mbajtët Zoti dorën e gazepit, se mos vijnë na i zhvasin dhe na i shesin për ok pako (për 5 lekë).

Ç’i shtyn këta zotërinj që veprojnë kështu?

Mbase forca e zakonit të lajmësit, por ky vetëm një palë këpucë do si shpërblim jo pasurinë. Mbase...!

I pari ka thënë: “Sherri do nge, davaja do para”.


Pra, na u dashka para për të bërë edhe një gjyq të dytë. S’prish punë, gjyqet bëhen kështu xhaba, pa para.

Kësaj i thonë të blesh me para pronën tënde.

Ç’e zuri të shkretin njeri e s’e hoqi. Zoti na nxjerrtë me faqe të bardhë nga ky soj mileti!

Qerim Hysenbegasi

Pse Nanoja na u kthye në



Kuvend?

Nanoja më në fund na u kthye në Kuvend. Ç’e gjeti, do të pyesni ju? Pse pikërisht dita e 23 janarit e nxori nga guva ku kalonte gjumin e tij letargjik?

Nuk është e vështirë të merret vesh. Sepse ata që e duan ta shohin përsëri në krye të politikës, i bën një zë se pikërisht në këtë ditë do të mblidhej Kuvendi në një sesion të jashtëzakonshëm për të nderuar Presidentin e Kosovës Ibrahim Rugova dhe ai duhej të bëhej i gjallë që të mund të caktohej në grupin qeveritar që do të merre pjesë në ceremoninë e varrimit që do të zhvillohej në Prishtinë ditën e enjte më 26 janar, krahas delegacioneve të shumë vendeve të botës.

Por si u mor vesh në këtë delegacion do të merrte pjesë Presidenti Alfred Moisiu, Kryeministri Berisha, Kryetarja e Kuvendit Jozefina Topalli, ministri i Jashtëm Besnik Mustafaj, dy kryetarët e grupeve më të mëdha parlamentare Bamir Topi dhe Pandeli Majko, kryetari i PS-së Edvin Rama, si dhe kryetarë të tjerë të partive politike... Për ish-Kryeministrin Fatos Nano nuk u kujtua njeri t’ia përmendte emrin.

Pse të ndodhte kështu?

Mos ia harruan emrin kaq shpejt? Kjo nuk është e mundur. Nuk kishte si të ndodhte. Po meqë emrin ia fshiu nga kujtesa e Partisë Socialiste kreu i saj Edvin Rama, s’kishte pse t’ia rishkruanin të tjerët.

Që të nisej si pjesë e një grupi të dytë joqeveritar, si i pavarur, këtë s’e besoj. Ai nuk pranon që të mbesë në hije. Ju e mbani mend si i doli përpara dhe ia mori fjalën nga goja Presidentit Moisiu në Vlorë?!

Kështu që kthimi i tij në Kuvend i vajti huq. Nuk e dimë nëse do të vazhdojë të qëndrojë në vendin e mbetur kaq gjatë bosh. Apo do të marrë rrugën drejt guvës së tij për të vazhduar letargjinë e tij?

Të shohim.

Pastaj, këtu jemi, mund të flasim sërish.

Agim Mehqemeja

## Dy fjalë për komisionin e vlerësimit të figurave

Pranë bashkisë, sa herë mendohet të vlerësohet ndonjë intelektual me ndonjë titull nderi për kontributet që ai ka dhënë, mbledhet një komision me intelektualë të njohur të fushave përkatëse që e gjykojnë çështjen. Dhe kjo është mëse normale dhe mëse e drejtë. Por ka ndodhur që në këto komisione ka marrë pjesë edhe ndonjë person pa personalitet që s' dihet si ka hyrë dhe pse është thirrur në mbledhjen e tij.

Shkas për të gjykuar mbi përbërjen e këtij komisioni u bë një ngjarje e padëshiruar që, fare rastësisht, e dëgjova në një nga ditët e këtij fillim viti në një nga kafenetë buzë rrugës kryesore të qytetit tonë.


Ishim ulur në një tavolinë disi të futur me vështrim nga rruga. Shokut tim të tavolinës i tërhoqi vëmendjen një bisedë pas shpinës sime.

Dikush që e quante veten si një nga anëtarët më me peshë të komisionit të vlerësimit të figurave pranë bashkisë së qytetit, tregonte me mburrje si kishte ndikuar mbi vendimin e këtij komisioni për t'i dhënë njërit prej intelektualëve të njohur të qytetit me kontribute të vlerësuar jo vetëm brenda qytetit, por edhe jashtë tij nga personalitete të shkencës, titullin më të ulët që kishte bashkia.

- E ç'punë ka bërë ky intelektual për qytetin e tij? Asnjë kontribut me vlerë nuk ka dhënë. Ata që e njihnin donin ta ngrinin në qiell, por unë nuk i lashë. Mjaft e ka atë kornizë që ia kanë vënë në mur!

Ktheva kokën.

Ishte një burrë i shkurtër. Që e njihja për fytyrë dhe që emrin nuk ia dija. Një njeri i panjohur, që s' dihet kur ka ardhur dhe nga ka ardhur në Berat. Që e dija se dikur kishte qenë anëtar i PD-së, më pas kaloi me Legalitetin, për të kaluar me PR-në dhe tani së fundit nuk e di se me cilën parti është lidhur. Një askush që nuk di në mund të quhet intelektual një i pashkollë si ky, që nuk shquhet për asgjë, veç se si tregtar flamujsh, që është një jabanxhi dhe që nuk ka mundësi jo vetëm për mungesë njohjeje, por edhe për nivelin e tij të ulët të japë gjykime në një komision të nderuar siç është ai i vlerësimit të figurave që janë



me kontribute për qytetin e Beratit. Mundet në emër të ndonjë partie (cilës partie i përket nuk dihet, se ai i ka ndërruar ato sa herë ka ndryshuar era e interesave të tij), ta ketë gjetur shtegun dhe të jetë bërë anëtar i këtij komisioni ose mund të jetë gjendur atje rastësisht dhe nuk e kanë nxjerrë jashtë atij takimi.

Mendoj se ky komision nuk duhet të ngrihet mbi baza partiake, se ka parti të vogla siç është edhe partia e këtij anëtar që përmendëm, që në mungesë të ndonjë intelektualit me vlerë, të dërgojë një njeri pa kulturën e nevojshme, si në rastin e përmendur. Dhe së dyti, në këto komision duhet të bëjnë pjesë qytetarë që e njohin fushën ku ka punuar dhe ka dhënë kontributet ai person që mendohet të nderohet me një titull nderi, që duhet të jetë edhe ai vetë një njeri i nderuar dhe jo një njeri pa dinjitet dhe një llafazan kafenesh.

Agim Mehqemeja

## Çfarë vlerësoj te historiani Asllan Sulo

Te një historian, nga që e kam mbajtur këtë peshë mbi shpinë, në ato raste kur jam marrë me kërkime në fushën e folklorit apo të letërsisë, vlerësoj kurajon e tij për të ndërmarrë trajtimin e një teme historike, sepse atij do t'i duhet të gërmojë nëpër arkiva dhe nëpër botime për të mbledhur materialin e nevojshëm, që nuk është aq e lehtë të gjendet dhe të përzgjidhet, më pas duhet ta njohë mirë atë material, duhet ta studiojë atë dhe, më në fund, të arrijë që të reflektojë mbi të, të bëjë analizat dhe vlerësimet e tij, që përbëjnë thelbin e punës krijuese që ka marrë përsipër të realizojë.

Kur bindesh se më në fund e ke arritur këtë parapërgatitje, atëherë vjen çasti të vendosësh që ta shkruash veprën. Sigurisht niveli i saj varet nga vërtetësia e fakteve të grumbulluara dhe aftësia për të reflektuar mbi ato fakte.

Mora shkas për të hedhur këto mendime nga promovimi i librit të katërt shkruar nga historiani beratas Asllan Sulo, rreth një teme të re nga historia e Beratit e shekullit XV, mbështetur në Defterin Turk të përkthyer nga orientalisti i njohur Vexhi Buharaja.

Kam para tavolinës së punës të katër librat e autorit: "Qyteti-muze i Beratit, popullsia", "Dy net që ngrinë Romën", "Ilias Vrioni" dhe "Berati në shekullin XV, sipas Defterit Turk".

Edhe pse librat janë të karaktereve të ndryshme dhe e trajtojnë historinë e qytetit të Beratit nga këndvështrime të ndryshme, vërehet me një shfletim të rastit puna tepër e lodhshme kërkuese e kryer nga autori. Dhe pikërisht ky vullnet i tij është për t'u lavdëruar.

Autori është i vetmi beratas që i ka dhënë me mundin dhe sakrificat e tij Beratit

katër libra që na zbulojnë anë të historisë dhe të kulturës së tij, edhe pse ka qenë larg arkivave dhe i duhej të udhëtonte drejt Tiranës me ditë të tëra. Kur historianë të tjerë po beratas, që janë punonjës pranë instituteve shkencore, nuk i kemi parë me asnjë botim shkencor për historinë e qytetit të tyre, Asllan Sulo del me librin e tij të katërt.

Berati është një minierë e madhe ku mund të hulumtoshe dhe të shkruash për të vepra historike me të cilat mund të bësh emër dhe të zësh një vend nderi midis historianëve të vendit.

Nga vlerat e mëdha kulturore dhe historike që ka mbartur dhe mbart Berati, shumë autorë jo beratas janë bërë sot me emër. Midis tyre po përmend Apollon Baçe, Emin Rira, Aleksandër Meksi, Ferit Duka, Shaban Sinani, Hëna Spahiu, Zija Shkodra dhe të tjerë, pa përmendur historianët e huaj që na kanë lënë vepra të mëdha për qytetin tonë.

Po historianët e njohur beratas, pse nuk e kanë marrë këtë mundim qoftë dhe një herë të vetme, ta kishin ngjyer atë të uruarën penë, duke u shkëputur nga angazhimet e tyre akademike, për t'i lënë pak kohë dhe për t'i kushtuar pak vëmendje Beratit të tyre?

Jo se nuk kanë mundur, po se mendojnë për bashkëpunime më të mëdha ku, për fatin e tyre të keq, nuk u bie në sy idekëtiteti, se pranojnë për arsytet e tyre të hyjnë në radhën e bashkautorëve apo të bashkëpunitorëve.

Pikërisht në përkushtimin e historianit Asllan Sulo, për të ndërmarrë nisma të tilla të vlerësueshme duhet të marrin shembull të gjithë ata historianë beratas që jetojnë larg tij dhe, siç thonë edhe vetë, se u qan zemra për qytetin e tyre, si dhe ata historianë që e kanë provuar penën nga një herë.

Berati i pret dhe do t'i mirëpres veprat e tyre!

Agim Mehqemeja

### Njoftim për vend të lirë pune

Në zbatim të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil" si dhe të urdhërit nr. 8, datë 13.01.2006, Bashkia e Beratit shpall konkursin për një vend të lirë pune në pozicionin:

#### PËRGJEGJËS SEKTORI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË DREJTORINË E BURIMEVE NJERËZORE

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme në nenin 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".

#### Kërkesat e veçanta për kandidatët:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë.
- Të ketë notë mesatare mbi 7.
- Të ketë mbi 10 vjet përvojë pune.
- Të ketë njohuri të programeve bazë të punës në kompjuter.
- Të ketë aftësi organizuese, komunikuese me gojë dhe me shkrim.

#### Paga bruto:

9000+2% për çdo vit vjetërsi pune + 24084 (paga për pozicion) në muaj.

#### Paraqitja e dokumentave:

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 13.02.2006 në Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për aplikim.
- Curriculum Vitae C.V.
- Fotokopjo të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.
- Çertifikatë të përbërjes familjare.
- Dëshmi kualifikimi (fotokopjo e noterizuar) nëse ka.
- Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.
- Dëshmi i gjendjes gjyqësore.
- Librezë pune.
- Dëshmi nga komisioni mjekësor kompetent që vërteton aftësinë për punë.

**Në datë 20.02.2006 në Bashkinë Berat do të shpallet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej si dhe data e testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.**

Konkurimi do të bazohet në njohuritë mbi Kushtetutën e RSH, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin "Statusi i nëpunësit civil", ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligji nr. 9367, datë 7.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", ligjin nr. 8305, datë 30.06.1999, "Për të drejtën e informimit", Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për etikën".

Bashkia Berat

### Njoftim për vend të lirë pune

Në zbatim të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil" si dhe të urdhërit nr. 8, datë 13.01.2006, Bashkia e Beratit shpall konkursin për një vend të lirë pune në pozicionin:

#### PËRGJEGJËS I SHËRBIMIT VETERINAR NË DREJTORINË E SHËRBIMEVE TË BASHKISË BERAT

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme në nenin 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".

#### Kërkesat e veçanta për kandidatët:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Fakultetin e Veterinarisë, dega Veterinari.
- Të ketë notë mesatare mbi 7.
- Të ketë mbi 10 vjet përvojë pune.
- Të ketë njohuri të programeve bazë të punës në kompjuter.
- Të ketë aftësi organizuese, komunikuese me gojë dhe me shkrim.

#### Paga bruto:

9000+2% për çdo vit vjetërsi pune + 24084 (paga për pozicion) në muaj.

#### Paraqitja e dokumentave:


Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 13.02.2006 në Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për aplikim.
- Curriculum Vitae C.V.
- Fotokopjo të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.
- Çertifikatë të përbërjes familjare.
- Dëshmi kualifikimi (fotokopjo e noterizuar) nëse ka.
- Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.
- Dëshmi i gjendjes gjyqësore.
- Librezë pune.
- Dëshmi nga komisioni mjekësor kompetent që vërteton aftësinë për punë.

**Në datë 20.02.2006 në Bashkinë Berat do të shpallet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej si dhe data e testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.**

Konkurimi do të bazohet në njohuritë mbi Kushtetutën e RSH, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin "Statusi i nëpunësit civil", ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligji nr. 9308, datë 04.11.2004, "Për shërbimin dhe inspektoriatin veterinar", ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

Bashkia Berat



Përgatiti faqen  
Bujar Orizaj

# Përse himni kombëtar këndohet i cunguar?!


## Himni Kombëtar

Rreth flamurit të përbashkuar,  
me një dëshirë e një qëllim,  
të gjithë atij duk'iu betuar,  
të lidhim besën për shpëtim.  
Prej luftës veç ai largohet  
që është lindur tradhëtor,  
kush është burrë nuk frikohet,  
po vdes, po vdes si një dëshmor!  
Në dorë armët do t'i mbajmë,  
të mbrojmë atdheun në çdo kënd.  
Të drejtat tona ne s'i ndajmë,  
këtu armiçë s'kanë vend!  
Se Zoti vetë e tha me gojë  
që kombe shuhen përmbi dhe,  
po Shqipëria do të rrojë,  
për të, për të luftojmë ne!

O flamur, flamur, shenj' e shenj,  
tek ty betohemi këtu,  
për Shqipërin' atdhen' e shtrenjtë,  
për nder' edhe lavdim' e tu.  
Trim, burrë quhet dhe nderohet,  
atdheut kush iu bë thërror,  
për jet' ai do të kujtohet  
mbi dhet, mbi dhet si një shenjtor!

gojë!..." e Po nuk mund ta pranoni  
ekzistencën e Zotit ateistët, që prishën  
kisha, xhami e teqe. Ateistët, me  
politikën e tyre antikombëtare nuk  
mund të pranoni se Zoti e donte

Shqipërinë njësh, jo pa Kosovën, që Juda i  
Gjirokastrës ia fali Serbisë apo që tradhtoi çështjen  
çame, duke mos u ndjerë për të drejtat e tyre mbi  
pronat e pasuritë e tyre, por duke burgosur e  
keqtrajtuar një popull, që erdhi në trojet e veta, por  
që me të u sollën si të ishin refugjatë të huaj dhe  
më e keqja duke u hequr të drejtën e nënshpëtësise  
së tyre si grekë që jetonin në trojet e të parëve të  
tyre. Po kishte dhe një shkak tjetër, që komunistët  
nuk e lejuan që të këndohej i plotë Himni i Flamurit,  
sepse kuadrot injorantë, duke filluar nga Koçi Xoxe  
teneqexhi e duke mbaruar te karrocierët e shoferët  
e byrosë politike, pa zënë në gojë drejtuesit  
komunistë nëpër rrethe, që ishin prodhime nga  
samarxhinjtë apo prodhim kooperativash bujqësore  
nuk e donin. Dikush mund të thotë se himni është i  
gjatë. Jo! Nuk është i gjatë. Dëgjoni himnin e  
Rusisë, të Italisë, të Gjermanisë, të Amerikës, të  
tërë janë më të gjatë se himni ynë. Kur vijnë  
delegacione të huaja, apo kur ekzekutohet nëpër  
mbledhje a veprimtari shoqërore, himni ynë më  
përpara mbaron se sa fillon. Vitet e fundit, madje  
dhe strofa që shërbente dhe shërben si refren: "Prej  
luftë veç ai largohet...", nuk po këndohet më 2 herë,  
por vetëm një herë! Ka ardhur koha që Kuvendi i  
Shqipërisë duhet ta rregullojë këtë mangësi. Unë i  
bëj apel deputetëve tanë, jo vetëm deputetit tim të  
zonës, të nderuarit doktor Xheka, por dhe 3  
deputetëve të tjerë socialistë, që shpesh diskutojnë  
me pasion për çështjet kombëtare, le të përipiqen  
të ngrënë një grup deputetësh për të parë ndreqjen  
e këtij gabimi të bërë 50 vjet përpara, por që  
vazhdon dhe sot ky gabim i bërë me qëllim. Si



mbyllje, për këtë shkrim dua të them se sistemi  
komunist bënte çmos që të fshihte autorësinë e kësaj  
poezie. Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, botim i  
vitit 1985 nga Akademia e Shkencave, në faqen 53,  
në kollonën e dytë të kësaj faqeje, aty ku flitet për  
Aleksandër Sotir Drenovën (Asdrenin), në 77 rreshta  
nuk thuhet asnjë fjalë për Himnin e Flamurit. Diku,  
ku përmenden disa poezi, thuhet se ka shkruar... dhe  
Himni i Festës (nuk e di në e kanë fjalën për Himnin  
e Flamurit, por nuk e ka saktësuar aspak profesori i  
nderuar Ko.Bi. që është (Koço Bihiku). Kjo nuk  
është bërë se profesor Bihiku nuk e dinte se kush e  
ka shkruar dhe si e ka shkruar, por se Akademia që  
drejtohej nga komisarët e Partisë, kishin rezerva si  
për rilindasin Drenova, si për Himnin e Flamurit.  
Le të jenë deputetët e Beratit ata që ta rregullojnë  
këtë gabim dashakeq të së kaluarës. Kur ta këndojmë  
të tërë Himnin ne beratasit do ta ndiejmë veten dy  
herë krenarë. E para, se e ndreqëm ne gabimin dhe  
e dyta se do të këndohet si duhet.

Kjo është poezia e shkruar nga  
Aleksandër Sotir Drenova (Asdreni), që u bë  
Himni i Flamurit, ose e thënë ndryshe Himni  
Kombëtar i Shqipërisë, kudo që jetonin, banonin  
e banojnë tërë ata që e quajnë veten bijë të  
shqipes e shqiptarë.

Dikur, para se komunistët të vinin në  
fuqi pas vitit 1944, bandat frymore, ose koret,  
këndonin të plotë këtë poezi, që do pranuar që  
çdo varg i saj, nga fillimi e gjer në fund, të  
mbushë me krenari e të fton që për atdheun e  
flamurin të mos kursesh as jetën. Komunistët  
hoqën ato vargje që binin ndesh me politikën  
sllaviste e grekomane, sepse diku në vargjet e  
himnit, në atë të 9 e deri në fund të kësaj strofe,  
thuhet se ne të drejtat tona nuk i ndajmë... (ku  
bëhet thirrje për të mbrojtur trojet tona kudo që  
janë në Kosovë apo Çamëri), dhe se këtu armiçtë  
s'kanë vend! Pas katër vargjeve ku mbrohej  
tërësia e trojeve të Shqipërisë, në vargjet që e  
pasojnë këtë strofë dhe e përbyllin atë,  
rilindasi ynë i madh thotë se "Zoti vetë e tha me

Kemi fituar apo jemi akoma në opozitë?!

Zotërinj!

Ç'është kjo vonesë, frikë, turp, pamundësi,  
dobësi apo allishverish e biznes politik?! Që nga  
shtatori kur u formua qeveria e kryesuar nga Sali  
Berisha, kanë kaluar 4 muaj e ca. Por në dikasteret  
e institucionet shikon po ata militantë, që  
shoqëronin Fatos Nanon dhe deputetët e zonës  
në të gjitha mitingjet, ku aprovonin çdo thënie  
të Fatos Nanos, Erion Braçes, Marko Bellos dhe  
Luan Memushit, se "demokratët nuk dinë të  
qeverisin, sepse nuk kanë kuadro, nuk kanë njerëz  
të përgatitur, ndërsa ne, socialistët, që kemi lindur  
dhe jemi caktues nga baballarët tanë (ish-ushtarët  
e bindur të diktaturës), dimë të drejtojmë këtë  
vend." Mediat e djathta dhe oratorët demokratë  
pretendonin të kundërtën, se kishin kapacitetet e  
nevojshme e të duhura për të drejtuar këtë vend,  
një mijë herë më mirë se socialsitët, që e çuan në  
vendin e 26 më të korruptuar të botës. Ku,  
korrupsioni, fillonte që nga kreu i qeverisë e  
mbaronte te roja i spitalit. Ç'u premtua, ç'u tha  
gjatë fushatës elektorale? U thanë plot gjëra. Ishin  
pikërisht këto premtime që u bënë për një  
qeverisje më të mirë, duke larguar të korruptuarit  
e duke vënë njerëz të zotë e të ndershëm. Pikërisht  
për këtë u votua opozita e djeshme, që e pagoi  
dobësinë e saj duke qëndruar jo pak, por tetë vjet  
në opozitë. Me të ardhur në fuqi në 97-ën, ata që  
dogjën e shkretuan Shqipërinë, i hoqën tërë ata  
që deri në 97-ën i kishte emëruar në punë Partia  
Demokratike. Duke filluar që nga pastrueset e  
bashkisë, juristët e llogaritarët, shefat e drejtorët,  
e deri te organet më të larta. U hoqën policë të  
zotë (jo ata që u hoqën me të drejtë se e kishin  
nxirë emrin e policit me veprimet e tyre të  
poshtra), u hoqën faktorinot e autobusave e  
faturistët e KESH-it, u hoqën tatimoret e  
inspektorët e sigurimeve, u hoqën financierët e  
ekonomistët. U hoqën të tërë ata që kishin votuar  
për PD. Vendet e tyre i zunë militantët dhe ata që  
dhe pa bukë rrinë, pa punë rrinë dhe pa ujë rrinë  
vetëm në qeveri të jetë partia socialiste, ish-  
bija e PPSH-së. Tetë vjet socialsitët në çdo zyrë që  
punonin në çdo vend që ishin nuk lanë rast pa  
ngjyer gishtat me mjaltin e fondeve që dilnin jo  
vetëm nga takast tona, por dhe nga ato para që  
jepte bota.

Pikërisht, për të hequr hajdutët kudo që  
janë, u votuan ata që prematuan reforma të thella.  
Po ç'po ngjet me këto reforma që duhen bërë  
kudo? Hiç gjë. Vetëm po të quajmë reformë ato

## Kryesisë së degës PD Berat, Prefektit z. Roland Bejko

pak vende që kanë zënë drejtuesit e partive  
të ish-opozitës. Por për këta drejtues, po  
punojnë militantët e socialistëve. Nuk e  
kuptojmë se si mund të realizohen synimet e  
qeverisë e të partisë demokratike me ata  
njerëz që jo vetëm nuk e kanë pranuar,  
përkrahur dhe besuar këtë reformë, por më e  
madhja, nuk mund të rrinë në ato vende kyçe  
ata njerëz që u prinë turmave të rrugaçëve  
për të djegur komisariatit, ku mbaheshin  
dosjet e tyre të krimit, duke djegur  
prokurorinë, ku mbaheshin akuzat e tyre për  
të kaluarën e "ndritur", që dogjën bashkinë  
e hipotekën ku ruheshin dokumentet e  
pronave, që dogjën zyrat e tatimeve e  
sigurimeve për të përfutur pensione e të tjera  
shpërblime. Në shumë zyra, janë po ata, që  
"dje" rrinin ilegalë nëpër qytete të tjera, ose  
lëviznin vetëm natën dhe me identitet të  
ndryshuar. Sot, kjo fundërinë, që doli nga  
errësira e natës së 97-ës, akoma tundet e  
shkundet se qeveria e re nuk u bën dot gjë,  
sepse i ruan statusi i "nëpunësit civil". Jo  
zotëri, jo, ata që dogjën Beratit njihen,  
dëshmitarët janë gjallë, të bëhet nga ish-  
drejtuesit e djeshëm akuzat me emra, për ata  
që bënë katraurën e jo të mbahen akoma në  
vende kyçe. Jo vetëm ata, por dhe ushtarët e  
tyre që në çdo palë zgjedhje që bëhen,  
organizojnë skuadrat e vjedhësve të votave  
e të sekserëve, që i blejnë këto vota.  
Ndryshimet e sistemeve të qeverisjes nuk e  
sollën 10-12 drejtorë me familjet e tyre. Këta  
10-12 drejtorë u shpërblyen me emërimet të  
rëndësishme, bile ndonjë dhe duke patur  
konflikt interesi midis punës së tij dhe  
emërimit.

Ç'po bëjmë kështu?! Hoqëm një  
palë hajdutë e të vëmë të tjerë hajdutë në  
punë! Kush ka patur dhe ka aktivitet privat  
dhe të fuqishëm madje, nuk ka pse kërkon  
dhe një thellë mbi bisht. Po ata demokratë të  
thjeshtë, që u hoqën nga puna vetëm pse  
votonin për demokratët, që për tetë vjet nuk  
firmosën asnjë herë në bordero shteti dhe sot


e kësaj dite rrinë pas dyerve të atyre që deri  
më dje ishin pozitë. A e dini ju zotërinj përse  
nuk realizohen apo derdhen pak para në  
buxhet nga tatimorët? Sepse punonjësit e saj  
kishin nga 5-6 dyqane që i "milnin". Po sot, a  
është pastruar ky subjekt nga hajdutët? Jo!  
Sot e gjithë ditën jo! Po kështu dhe në  
sigurimet shoqërore, po kështu dhe te taksat,  
po kështu dhe te zyrat e punës. e kudo. Në  
policë për fat të keq, jo policë por titullarë ka  
me deftesa të fallsifikuara. Pa zënë në gojë  
që edhe në shumë zyra të tjera tetëvjeçaristët  
janë bërë universitarë! A e dini përse në rrjet  
kemi 34% humbje energjije? Sepse 34% e  
familjeve dhe bizneve, ose nuk kanë kontrata,  
ose familjet kanë deklaruar se janë në  
"Greqi". Kush i bënë këta? I bëjnë ata që PS iu  
dha shpërblimin për djegiet që i bënë qytetit.

Janë ata që u bënë me vetura, me shtëpi  
e biznese duke vjedhur faturat, që nga 20 000  
apo 25 000 lekë të vjetër, i "vilnin" për vete  
nga 5000 apo 8000 lekë të vjetër çdo muaj.  
Dhe këto vende u zunë nga militantët, që  
morën dhe vendin e punës dhe deftesën fallco  
të shkollës së mesme. Këta "nëpunës të  
vegjël", nuk janë njerëzit e ndershëm, që i  
japin shtetit çfarë i takon dhe vetë marrin  
vetëm rrogën që u takon me ligj. Po a mund  
të mbahen në punë ata drejtorë shkollash që  
vinin nxënësit në radhë dhe i nxirnin të  
prisnin kryetarit e Partisë Socialiste? Ç'punë  
kishin nxënësit me kryesocialistin? A mund  
të mbahen në punë ata drejtorë që janë kundër  
reformës, që propozonte Sali Berisha? Në tërë  
vendet e thjeshta të punëve që nga pastrueset,  
sanitarët, llogaritarët, arkëtarët, drejtorët  
politikë që emëroi PS pas 97-ës, u bënë  
zëvendësime të pajustificueshme. Atëherë  
nuk ndihej kush, se "çunat" që sapo kishin  
hequr maskat të bënin namin. Në tërë nivelet  
e ulëta të punësimit u hoqën ata me bindje të  
djathta, që me krenari ulërinin: "Zemra  
majtas, vojto majtas!" Këta dhe bukë filluan  
të hanë me të majtën, u bënë të tërë sallaqë.  
Po të ishin në këto vende pune ata që la PD-

ja në 97-ën, sot nuk kishte përse t'i hiqte. Tërë  
drejtorët, tërë drejtuesit dhe aty ku posti nuk është  
politik, por që nuk kanë besim te reforma, duhen  
hequr. Në punë duhen mbajtur ata që me mish e  
me shpirt i jepen punës, pa menduar për vete.  
Nënkryetari demokrat Bamir Topi tha se "duhen  
bërë ndryshime në qeveri, sepse disa ministra po  
tregohen apatikë". Mos vallë këta ministra do t'i  
marrë nëmbrojtje PS, se nuk punojnë? Kush nuk  
punon, kush nuk ka besim te reforma, kush nuk  
punon që kjo reformë të realizohet siç është  
konceptuar nga kreu i qeverisë dhe specialsitët,  
duhet të hapë krahun e t'i lirojë rrugën shokut,  
që di të ecë në këtë trafik që lanë me rrugë të  
pashtruar "Socialistët". Nuk duhet të ketë as frikë,  
as "turp", as drojtje. Ne do t'i realizojmë ato që  
thamë me njerëzit tanë.


Dhe një gjë tjetër duhet të kemi kujdes.  
Nuk kam asgjë për kuadrot që vijnë nga fshati.  
Por të mos harrojmë se për tetë vjet kritika jonë  
që se Beratit po e qeverisin dhe e drejtojnë  
fshatarët. Sot jo pak nga fshati janë caktuar në  
poste, ku me siguri që do të punësojnë të ardhur  
të tjerë nga fshati. Pyetja është kjo: A ka qyteti i  
Beratit bijë e bija të tijtë të lindur e rritur e banues  
në qytet, që t'i vërë në vendet që duhet? Nëse  
nuk ka, atëherë, unë botërisht i kërkoj të falur  
tërë vëllezërve nga fshati të dy krahëve, se teoria  
e Mao Ce Dunit: "Fshati të rrethojë qytetin", do  
kuptuar "Fshati të drejtojë qytetin". Paska  
triumfuar tani në vitin 2006 dhe në Berat.

Zotërinj, po afrojnë zgjedhjet për  
pushtetin vendor. A e keni bërë hesap se me kë  
do ta bëni fushatën? Me 10-12 drejtorë gjysma  
nga fshati dhe me fëmijët e tyre? Këta do të jenë  
pak, shumë pak për të fituar pushtetin vendor, që  
është detyrë e domosdoshme. Realizimi pushtet  
vendor me pushtetin qendror do ta sabotojë  
reformën sidomos kur opozita ka në krye një  
leadership që di vetëm të krijojë konflikte jo vetëm  
me kundërshtarët, por dhe brenda radhëve të të  
tijve. Me Edi Ramën nuk bën prokopi vendi jo  
që jo, por as vetë partia socialiste. Prandaj, bëni  
pazaret mirë me veten. Mos harroni: "zogjtë e  
kllloçkës numërohen që në vjeshtë!". Vendi,  
ekonomia, demokratët, votuesit dhe emira e  
punës, presin reformën e plotë e jo sa për të larë  
gojën se gjoja bëme ndryshime, se ne jemi  
tolerantë e nuk jemi si ata (socialistët), që hoqën  
nga puna që nga pastrueset e deri te specialistët  
dhe akademikët. Sa më shpejt, sa më mirë e sa  
më ndershëmrisht të bëhet, aq më mirë do të jetë  
për vendin, për popullin, por dhe për Partinë



Namik Selmani

# ETIKA – midis ligjit e moralit



Bisedoja një ditë me një mik që vinte nga Bostoni i SHBA. Kishte disa vite që kishte shkuar në këtë qytet e, në një farë mënyre, kishte njohur sadopak psikologjinë amerikane, natyrisht krejt e ndryshme nga ajo e shqiptarit. Sa herë që vjen në qytetin tonë, takohemi, çmallemi e përcjellim mendimet e njëri-tjetrit.

- Ç'mund të më thuash kësaj radhe ndonjë gjë të veçantë nga Amerika,- i thashë.

- Ka një gjë të veçantë Amerika,- më tha.- Ti do të thuash punohet shumë. Po, po, shumë punohet dhe gjumin nuk e bën të mjaftueshëm. Nëse do të them për këtë gjë, nuk do të them ndonjë gjë të re, sepse këtë e thonë të gjithë ata që kanë qenë e ata që s'kanë qenë në këtë vend të madh. Por mua më bëri përshtypje një etikë masive që e sheh në çdo vend, në çdo orë të ditës e të natës, kur vendos qoftë edhe kontaktin më të vogël me një të bardhë a zezak, të vogël apo të madh, me pushtet, apo njeri të thjeshtë, në qendra qytetesh apo të periferive të tyre. Kudo dëgjon fjalët: "Faleminderit! Të lutem! Më falni! Urdhëro! Si urdhëro!" Natyrisht duke i shtuar edhe mirësjelljen, buzëqeshjen njerëzore. Pa një ligj shtetëror të shkruar diku në ndonjë vend, ky është një ligj i pashkruar që e dinë të gjithë dhe e zbatojnë të gjithë. Një çast u çudita. Prisja të me tregonte për pallatet me shumë kate, të më tregonte se si fitoheshin dollarët e ëndërruar nga të gjithë në atë vend, për rrugët, për dritat, për supermarketet e mëdha, për artistët e çuditshëm, për muzetë... dhe ja, miku im ma futi bisedën në këta sinorë befasues.

Një çast nisa të meditoja për klimën e ETIKËS në Shqipëri. Nuk dua të nxij traditën e së kaluarës. Patjetër as ta zmadhoj rolin e saj në një edukim masiv të rinisë e mbarë popullit duke krijuar... faktuar për kë... e mirë e brez... të një moshë... jve e klient... e saj pozitiv... shme ky ko... cjellë edhe... ga ana tjetër... esi të

mbyll sytë para brishtësisë, pse jo, edhe para deformimit të kësaj ETIKE në ditët tona që shprehet jo vetëm te fjala e artikulluar.

Ta nisim nga shkolla. Rrallë gjen mësues që në të gjithë përditshmërinë e tyre në marrdhënie me nxënësit, por edhe me kolegët të përdorin fjalët; "Faleminderit !Ju lutem!" Nuk mund të përjashtojmë edhe nxënësit që me dashje, apo pa dashje, zhdukin kufijtë e ETIKËS. Brutaliteti dhe mungesa e tolerancës shpesh bëhen "mbret" i komunikimit.

Tradicionalizmi natyrisht ka vlerën e vet negative ose pozitive të nxënësit. Vështirë të gjesh nëpër lokalet e shumtë të shërbimit ku kamarjeri të ketë në fjalorin e tij në të gjithë orët e shërbimit të tij me klientët fjalët e mësipërme. Nuk e sheh këtë në autobusët urbanë, në rrugë...

Ta vazhdojmë me një problem tjetër që lidhet me ETIKËN, ai i paraqitjes së kulturuar të pamjes së jashtme të personelit të shërbimit. Nëpër autobusët urbanë në të gjithë vendin e ke të vështirë që të kuptosh se kush është faturinua. Mes asaj mizërie njerëzish në autobusët tanë urbanë doemos etika duhet të jetë primare në përditshmërinë e saj. Me ca rroba të vjetra, me ca lekë të shkoqura në duar faturinua të del përballë e të kërkon paratë. Nuk e dimë se sa llogari i kërkojnë drejtuesit përkatës këtij personeli. Kur vjen radha për para, ata ia kërkojnë një për një e nuk mendojnë që ata të pajisen qoftë dhe me një uniformë të thjeshtë e të pastër identifikuese

Nëse në lokalet tradicionale të qyteteve tona është bërë një gjë e mirë për pajisjen e personelit me uniformën që i përgjigjet vetë lokalit, këtë gjë nuk e sheh në të gjithë lokalet, qofshin këto edhe gjellëtore. Madje mund të numurosh me gishta lokalet që e respektojnë këtë status.

Ndoshta duhet menduar edhe për uniformat e shkollave. Pajisja me një uniformë të veçantë për secilën shkollë është kulturë, është identitet. Nëse ndonjë shkollë e bën, kjo bëhet vetëm për dy muaj në vit në shtator dhe në muajt prill-maj. Para disa vitesh u bë një punë e mirë në shkollën e mesme "Babë Dudë Karbunara" të qytetit të Beratit për pajisjen e nxënësve dhe mësuesve me kartat e identitetit, por kjo nuk u vazhdua, nuk u përhap dhe as që mendohet të bëhet. Për fat të keq këtë gjë nuk e sheh as te punonjësit e bashkisë apo të institucionve të tjera shtetërore apo joqeveritare. Vështirë e ke të shohësh një gjë të tillë edhe nëpër korridoret e institucionieve të Ministrive tona. Në një vizitë që bëme para dy vitesh në rajonin e Markesit të Italisë me rreth 2 milionë banorë që kishte si kryeqendër administrative qytetin e Ankonës, e kishim të vështirë që të shihnim një nëpunës pa këtë kartë në gjoks, madje as nëpunësit e rojes...

Në të gjitha rastet e mësipërme ligji e morali bashkohen aq ngushtë me njëri-tjetrin, sa nuk e gjen dot kufirin e fillimit e të fundit të secilit.

A duhet të jemi aq naivë që për këtë fajin t'ia vëmë politikës? Jo. Gjithnjë këtë mund t'ia faturim edhe

traditës që, për interesa të çastit, shumë e nxijnë. Nuk mund t'ia vëmë as varfërisë që është e pranishme në jetën tonë. Nëse kërkojmë të aspirojmë në shoqëri dhe civilizuar evropiane e më gjerë, duhet të hapim së pari shtigjet e ETIKËS për të gjithë e të bëhemi spartanë modernë. Mbase mund të mendohet për ca sanksione ndëshkuese.

Si problem të problemit do të shtronim një pyetje: A është i përgatitur opinioni, komuniteti shqiptar për këtë ndryshim masiv?

Nuk ka përgjigje të prerë, po fabula e rrëfimit të mëposhtëm mund ta vërë në një peshorë të re pyetjen. Me shumë sinqeritet një djallë që kishte jetuar në një qytet të Italisë Veriore më tregoi se një ditë, pasi kishte ngrënë një hamburger, i ulur në një stol, e hodhi letrën në tokë, diku pranë stolit. Një grua e moshuar që ishte në këtë stol i kthehet e me shumë rreptësi i thotë:

- Ti je i huaj! Na e bëtë pis Italinë! Pse e hedh letrën aty?

Nuk dimë se si do të reagonte një shqiptar anonim kur të gjendej përballë këtij gabimi.

Etika është një pistë e re ku duhet të bashkohet kombi. Është një auditor ku këshillojmë vetveten. Që të mos na ndodhë ajo, më e keqja, mungesa e ekuilibrit të kulturës.

Mbase nuk do të jetë e largët dita, kur të gjithë evropianët apo amerikanët pas një vizite që do të bëjnë në Shqipëri, do t'u thonë bashkatdhetarëve se atje (në Shqipëri) vërtet nuk ishte mirëqenia e Evropës e Amerikës, por njerëzit ishin tepër të sjellshëm, të kulturuar,

## Ka kohë që...

(Çdo emigrant do të ndihet krenar, kur atij në x qytet, të y shteti këndohet Himni Kombëtar, e ngritja e flamurit kombëtar të Shqipërisë, për një ngjarje a shpikje që ka bërë shqiptari.

Me urdhër të MASH, z. Genc Pollos, nëpër shkolla duhet të këndohet Himni Kombëtar e të ngrihet Flamuri Kombëtar çdo mëngjes nëpër shkolla. Por ç'punë është bërë për këtë nga drejtoritë e stafet pedagogjike nëpër shkolla? Shihet e mendohet se nuk ka filluar seriozisht kjo punë.

Për këtë, disa javë më parë, filloi një punë e mirëfilltë nga shkollat e mesme e bashkuar Starovë dhe shkolla e mesme "Kristo Isak" Berat. Aty u ngritën grupet e punës në disa drejtime:

Grupi i edukimit fizik- për paraqitjen e nxënësit të shkollës si vendosja, radhimi, hapësira, largësia e klasës nga klasa, deri në integrimin e vetë shkollës në tërësi.

Grupi i departamentit të gjuhës e të letërsisë, duke futur këtu edhe këshillin e bibliotekës, që të mësohet e komentohet Himni Kombëtar.

Grupi muzikor ku mësohet melodia pjesë-pjesë e më pas i tëri Himni Kombëtar.

Grupi që lodhet më shumë, ai i mësuesëve kujdestarë. Të gjitha këto grupe, hartuan planet dhe filluan nga puna. Rezultatet në miniaturë ishin të kënaqshme.

Harmonizimi i të gjithë grupeve, jep e del vetvetiu, në zbatimin e pjeshme të plotë të urdhërorit të MASH.

Të mësuarit e Himnit e të ngritjes së Flamurit, janëtribute të kombit tonë. Që secili që largohet nga Shqipëria, të dijnë këto dytribute të Kombit Shqiptar, siç bën sportisti në hyrje të ndeshjes. Kështu të bëjë çdo emigrant kudoqoftë në botë. Po kjo do bërë çdo herë e në çdo skutë të atdheut tonë siç bën artisti në shkallë ndërkombëtare, kur përfaqëson shtetin e tij në botë.

Ja, pra, pse duhet për çdo shqiptar ngritja e flamurit, shoqëruar me Himnin Shqiptar.

## Ca mësuesë të nënës, ca të njerëks

ji Bendi

Tashmë jemi mësuar me gjërat që ndodhin rreth nesh. Sado na duken të padrejta, të pavend, por prapë themi: "Epo çdokush do veprojë sipas interesit të vet". Kërkojmë me çdo kusht që të na njihet e drejta jonë por askush nuk na mbiron, ose më mirë askush nuk thotë se fjala jote është e vërteta dhe duhet ta mbrosh edhe pse ndonjëherë të kushton shtrenjtë. Të bën të dalësh nga vetvetja, të bëhesh i keq dhe ... "llafazan".

Kush janë njerëzit më të respektueshëm në Shqipëri? Po ata që kanë rrogën më të lartë?

Dikur profesioni që të jepte rëndësi, respekt, autoritet, njëfarëlloj pushteti, interesi po edhe kulturë, mirënjohje, dhembshuri, dashuri etj, ka qenë mësuesia.

E themi "ka qenë", sepse asgjë nga këto tani që cilësuar" nuk janë zhdukur në asgjë. Mësuesit janë njerëzit të cilët e mbajnë lart një komb, kulturën, gjuhën, vlerat kombëtare të tij. Mësojmë dhe edukojmë brezin e ri, i japin dije, edukatë, por edhe dashuri jo vetëm për njëri-tjetrin, por edhe për gjuhën shqipe, të duan dhe të respektojnë vlerat por edhe mangësitë e këtij populli. Por ç'bëhet me këta që gjysmën e ditës së tyre e kalojnë me fëmijët...?

Punë, lodhje, por edhe kënaqësi, përbuzje, mosinteresim, neglizhencë... e nuk di ç'të them më.

Por më në fund dikush u kujtua për këta njerëz dhe për të vlerësuar sado pak punën e tyre u dha një shpërbim të gjithë mësuesëve edhe atyre me vjetërsi pune, por edhe atyre të rinjve, që ende nuk e kanë marrë atë të quajturin "vendim". E morën dhe falënderuan, sepse një rrogë e vogël që u jepet janë gati edhe për lëmshë. Të rinjve u rritet shpresa se diçka mund të ndodhë me profesionin e tyre se nuk duhet të bëhen pishmën që zgjodhën këtë degë, se më në fund dikush do t'i japë rëndësinë që u takon, pra, më në fund do të shpërblehen për punën e tyre. Po ç'ndodh me mësuesit e disa fshatrave të Beratit dhe konkretisht në komunën e Kutallisë?!

Bëhet një deskriminim, vjedhje e parave të mësuesve. U dha shpërblimi për mësuesit pa rëndësi në ishte i vjetër ose jo, me vendim apo jo, të gjithë do e merrnin. (Fjalët e ministrit). Ndërsa për komunën e Kutallisë kjo nuk është e vërtetë, shpërblimin do ta merrnin vetëm ata që ishin me vendim, por ndërkohë paratë ishin tërhequr edhe për pjesën tjetër. Atëherë lind pyetja: Ku shkuan paratë e tjera? Përdërisa ato para mësuesit nuk i morën, kush i mori atëherë?... Nëse vërtet komuna nuk i ka tërhequr vërtet ato para (siç pohon ajo), përse nuk ia vërteton një gjë të tillë të interesuarve por i përcjell me përbuzje dhe përcmim duke i thënë se: "Nuk u japim llogari juve, nuk tregojmë asnjë shkresë dhe tani dilni që këtu". (Kjo s'është hera e parë, po meqë nuk ka kush t'i ndihmojë... hanë hienat).


Atëherë, dua t'ju drejtoj një pyetje: A janë dhënë vërtet këto lekë, a u takon atyre të marrin një shpjegim dhe ku ta kërkojnë të drejtën? (Këta njerëz që për vite e vite me radhë kanë nxjerrë në jetë breza të tërë intelektualësh, punëtorësh). Gjithmonë duhet të luftojmë me veten e tyre dhe në heshtje, sepse askush nuk i dëgjon edhe sikur ta ngrejnë zërin? Si thoni ju?...

# Konkursi "Pegas 2005"

Gazeta "Lajmëtari i Beratit" njofton të gjithë krijuesit se vazhdon konkursi letrar vjetor "Pegas 2005", deri të hënën e fundit të muajit shkurt 2006, ditë ku do të shpallen fituesit.

*Konkursi do të zhvillohet:* a. për esse-në më të mirë. b. Për prozat poetike më të mira. c. Për ciklin me poezi më të mira.

Lajmëtari




*Te shohesh nje bote ne nje kokrrize rere*

*Dhe qiellin ne nje lule te eger*

*Te mbash Pafundesine ne pellembe te dores*

*Dhe perjetesine ne nje ore.*

*William Blake*



## Fjala

E harrova veten... përlohem përpara disa shkronjave që u harmonizuan ëmbëlsisht në shpirt duke formuar një fjalë të vetme. Bukuria e saj më prangosi lehtësisht mendjen dhe ashtu e hutuar vazhdoja të mendoja për të. E ndieja që pak nga pak ajo po i jepte shkëlqim dhe pikës më të errët të qenies sime. Ka momente, ku çdo njeri ndihet i braktisur, mbi të gjithë nga shpresat dhe fjala është e vetmja që mund të shërojë edhe sëmundjen më të hidhur të ekzistencës.

Vetëm një fjalë dhe gjithë jeta merr kuptim. Ajo ka çelësin e çdo zemre, që kërkon rifillimin e një jete të përjetshme, të një jete hyjnore, pa vuajtje shpirtërore dhe ndërgjegje të copëtuar. Aroma e saj e hidhur apo e ëmbël sinjifikon një mbështetje, një mendim. Dhe, thjesht ideja që dikush po të kupton, këto fjalë tejçohen drejt arsyes, e cila gjykon që fjala është gjithmonë ajo që na nevojitet.

Dal nga kjo gjendje ankthi dhe ngurtësimi letargjik që më kishte pushtuar trupin, nisi të largohej, duke braktisur së pari zemrën... Nisa të marrë frymë lirisht duke u ndjerë plotësisht e pavarur në mendimet e mia.

Ngre sytë nga qielli dhe e shoh përsëri, si gjithmonë hyjnore.

E çuditshme

Sa fare pak kërkoj!

Vetëm një fjalë...

## Proza

nga Lulëzim Halili  
(Jashtë konkursimit)

### Dyzim

Njeriu vetëvritet çdo çast dhe kur një mëngjes me re të zeza harron ta bëjë këtë akt të nevojshëm për qënien e tij, gjendet i vetëvarur nga familjarët, që ndërkohë kanë vënë kujën e çjerrin faqet prej dhimbjes e zisë së madhe, që ka pllakosur familjet dhe fiset e tyre. Ky është momenti vendimtar i jetës, ku gjamuesit dhe vajtueset duhet të bëhen burra të fortë e të ndjekin ceremoninë pikë mbas pike, pa gabuar aspak, ndryshe bota do të qeshet.

### UNE JAM, PRA....

Me sytë e enjtur nga pagjumësia shoh në pasqyrë veten time, që nuk më pëlqen aspak. Prej shëmtisë thyej xhamin e akullit ku pikturohet fytyra ime binjake. Pasqyra tani s'është më dhe përdhe shoh mijëra copëza, që më tallin pabesisht për gjestin tim të mospranimit.

### FOLK !


Thikën të ngul në zemer dhe gjakun ta pi plot dashuri. Të mavijos krejt trupin e puthjen si melhem ta vendos mbi plagë. Prej pusit të zemrës më lind urrejtja në fjalët e mia plumb; natës qorre të rendis në vesh vargje hyjnore, që i rremben qielli për t'i ruajtur. Duart, zhguaj të janë bërë prej babëzisë sime; si thithka sisësh m'i avit kur natën vonë bëhem foshnjë zevzek. Gunë e ashpër të rëndon mbi supet e shtrembër; era e malit fisnik flladit pastaj me aromën verdhoshe të portokalleve majoshe në gishtat e mi të gjymtuar.

Skllavja që jep urdhra më je !

Brezat më varin në qafë si varëse të stërmadhe e unë një vesh e kam të shurdhet e një sy e mbaj të mbyllur. Merret me mend: Të djathtin !!!

### Alfabeti i gjuhës sime

E di mirë se jeni armiq të e mi !  
Madje, të betuar, si ata Sangreal-it. Në ballë do të donit të më ngulnit një heshtë të hekurt, që gjithë jetës t'i mbaja sytë mbyllur, apo të paktën t'i mbaja ulur përdhe, si një nuse plot nur, që në shpirt i vlon urrejtja për natën e parë dhe lut si legjenda e vjetër një humnerë poshtë këmbëve të saj. Por prapë ju dua fort! Çdokush nga ju më është një armik i ëmbël. Historinë që më keni lypur do t'ju zbraz të gjithë në përjetësi, si një lësh gjigand prej...



ngjyroste ndryshe. Mëkatin ajo mbante në shpinë: ca mjalte për t'më lyer buzët herë pas here prej etjes së madhe.

Tani e tutje do të shihja i verbuar përmes baltës së kuqe.

Do të dëgjoja zërat e jetes fill mbas baltës së kuqe.

Do të nuhatja gjithçka me aromën e baltës së kuqe përzier.

Do të shijoja ç'ka na kanë dhuruar, të hidhur a të ëmbël, me copa balte të kuqe ndër gjuhë.

Do të prekja me duart pisanjose gjokse kupash përlyer më baltë të kuqe.

Ndoshta, do të shihja ëndrra gjysmë të vërteta me prapaskena njollosur me baltë të kuqe. Me maskën varur në ballë, si një burrë i ndershëm, u vërtita rrugëve të botës, ku në çdo derë që trokisja me prisnin si arketip. Gënjeja për të qënë gjindja e lumtur dhe vetes i afroja përsëri tek buzët ca mjalte të freskët të përditshëm. Ç'fat!

Nuk ju shoh por e ndiej se zgërdhiheni në nënqeshje, duke dëgjuar historinë time që po ju vjen për mbarë. Por një ditë unë u rrezova në një hon të thellë e të errët që sa vjen e zgjerohet dhe ... maska m'u thye. Tani, tani erdhi koha të vajtoni përjetësisht! Jo për baltën e thyer por se në vend të shenjave imorale në ballin tim ishte gdhendur gjithë alfabeti i gjuhës sime, me kombinime të pafundme.

### A është çdo njeri artist?!

Mbi kapelet e tjegullta të qyteteve ka ca ditë që ashtu siç janë të sëmurë në rrugët e frymëmarrjes, kolliten në ca oxhaqe gëzimi, që nxjerrin tym festiv. Turma ekstazën ta përplas në grykë dhe shkëlqimi ju regëtin në sytë e ftohtë. Lumturia përhapet, si një epidemi në mbarë globin e vogël. Aty ka për të gjithë një copëz parajsë. Zgjatësh pak e hareja, që shkakton lumturia e familjeve të troket gjithë madhësi në thellësi të veshëve dhe njeriu i vogël ndjen t'i kalojnë në rrugët e panjohura tingujt e urryer, që mblidhen e mblidhen në fundin e një shpelle, tamam aty ku mendon dhe ti, në ato dritëhije, për t'u bërë uji, nëqoftëse ti (më falni) je peshk dhe bashkëjeton në simbiozë me të. Ne jemi të mallkuar, që atehere kur në ballë na pikturovan sytë rrathë-rrathë, që për fatin tonë të zi nuk ua kemi në dorë rrotullimën e as shtrimin e shinave të vështrimeve gjithmonë drejt kureshtisë. Këtu lind mëkati i imitimit, kuptohet, vizual, dhe ne vuajmë në heshtje. Qepallën e hekurt doja t'i lypja njeripunuesit, që botës t'ja mbushja mendjen duke i rrefyer në vesh çdo natë nga një përrallë për t'u zgjuar. Por ç'them?! Unë vetë jam në gjumë, thjesht, sepse shoh dhe dëgjoj paprerë. Shpëtimi im është si dielli në një qiell të sterrosur, ku me retë në fyt ai çan gardhin për t'ja shkelur syrin tokës dashnore, që lëngon nën shi. Sa shumë shi që bie në vendin tim! Sa shi! Po të ishte kthjellët do të dukeshin mijëra diej edhe ata me të largët, që digjen në vetvete në errësirën e ekzistencës. Sa shumë shi që bie në vendin tim. Sa shi! Por e di, dielli do të lindë një ditë edhe në vendin tim! Dielli do të lindë!


# Kosova i jep lamtumirën e fundit presidentit

## Ceremonia mortore për presidentin Ibrahim Rugova

Qindra mijra njerëz në Prishtinë kanë marrë pjesë në funeralin e presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, që u nda nga jeta fundjavën e kaluar në moshën 61 vjeçare.

Familjarët e zotit Rugova, udhëheqës dhe politikanë kosovarë dhe ndërkombëtarë si edhe mbi 30 delegacione nga vende të ndryshme të botës, ndër ta presidentë, kryeministra dhe ministra të qeverive respektive, morën pjesë në një ceremoni mortore në sallën 1 Tetori. "Rugova ka qenë elementi përcaktues i politikës në Kosovë për sa kohë që është e vështirë për ne për ta imagjinuar Kosovën, politikën e Kosovës, pa të," the kreu i UNMIK-ut Soren Jessen-Petersen. Më pas arkivoli me trupin e pajetë të presidentit Rugova kaloi i shoqëruar nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës nëpër rrugët e Prishtinës, ku mijëra kosovarë kishin dalë për t'i dhënë lamtumirën e fundit presidentit të tyre. Njerëz duke qarë hidhnin lule mbi arkivolin e mbuluar nga një flamur me shqiponjë dhe sfond kuq e blu. Trupi i tij u varros në varrezat e dëshmorëve, në Velani, të cilat gjenden vetëm disa qindra metra larg shtëpisë dhe residencës së tij. Deri në përfundimin e luftës në vitin 1999 aty nuk ka pasur varreza. Ka qenë vetëm një përmendore e quajtur Vëllazërim-Bashkim, ndërsa

pas luftës aty janë varrosur disa pjesëtarë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Thuhet se ka qenë dëshira e presidentit Rugova që të varroset në këto varreza. Në të ardhmen mendohet që aty të ndërtohet një memorial ku qytetarët do të mund t'i bëjnë nderime kryetarit të parë të Kosovës, Ibrahim Rugova, i cili angazhohej në vazhdimësi për pavarësinë e Kosovës. Reagimet e para pas vdekjes së presidentit të Kosovës Ibrahim Rugova, kanë qenë të jashtëzakonshme. Është shprehur dhembje dhe keqardhje deri në skajshmëri. Kosova po mban 15 ditë zie kombëtarer ndërkaq Shqipëria tri ditë. Qindra mijëra qytetarë, për pesë ditë rrjesht qëndruan në rradhë të gjata, në një mot tepër të keq dhe në temperaturat shumë të ulta, për t'i dhënë nderimet e fundit presidentit të tyre. Marti Ahtisari, Komisioneri Evropian për Zgjerim, Olli Rehn, ministri për Evropën në qeverinë britanike, Douglas Alexander, i dërguari i SHBA-së për Statusin Frank Wisner si dhe presidentë, kryeministra dhe ministra të jashtëm të dhjetra vendeve të tjera. Në mesin e tyre është edhe presidenti shqiptar Alfred Moisiu.



## Rugova si shkëmbi në stuhi


*Kouchner e quajti Presidentin Rugova "një shkëmb në stuhi"*

**Ish kryeadministratori i Kosovës, Bernard Kouchner thotë se cilësia e Presidentit Ibrahim Rugova që do të mbahet më shumë mend ishte gjakftohtësia e tij.**

Ai ishte si një shkëmb në kohë stuhie në Kosovë," i tha ai BBC-së. Zoti Kouchner, aktualisht profesor nga ana tjetër beson se magnetizmi i Rugovës do të përcillet nga gjenerata e

afërt. Ai fillimisht i përgjigjet pyetjes se kur e kishte takuar për herë të parë zotit Rugova. **Kouchner:** Hera e parë që e takova zotit Rugova ishte viti 1992, isha ministër në qeverinë e presidentit Miterand. Ishte e vështirë asokohe, sepse Beogradi nuk e lejoji këtë vizitë edhe u përpoq që të na kërcënonte. Unë vizitova Kosovën dhe takova për herë të parë mikun tim Ibrahim Rugovën. Ai ishte kreu i një lëvizjeje fantastike pacifiste, që protestonte ndaj aparitit dhe Millosheviçit që e kishte vendosur këtë aparit. Ishte një rezistencë fantastike. Ishte hera e parë që kaluam disa ditë sëbashku. Që prej asaj kohe ne u takuam disa herë. Më pas unë mora detyrën e kreut të UNMIK-ut për dy vjet dhe pata krenarinë dhe nderin ta takoj përditë mikun tim Ibrahim Rugova. **BBC:** A besuat që në takimin e parë se zoti Rugova do të ishte personaliteti që do ta drejtonte Kosovën deri në këtë ditë? **Kouchner:** Po, por jo vetëm se unë isha i sigurt, por sepse ai që atë kohë e kishte treguar veten si njeriu më i vendosur, i motivuar dhe i mençur dhe aktivisti më i mirë në Kosovë. Dhe në mënyrën e vet ai i shfaqti këto cilësi duke ruajtur distancën, me shumë qetësi dhe me këmbëngulje. Ai e urrente luftën, i urrente armët dhe dukej si figura e Kosovës. Që në atë kohë ai dukej si babai i Kosovës. **BBC:** Në vitin 1999 ju morët detyrën e kreut të UNMIKut dhe siç e thatë patët privilegjin të punonit përditë me zotit Rugova, cili ishte tipari më i veçantë i karakterit të zotit Rugova? **Kouchner:** Aftësia për të ruajtur gjakftohtësinë në momente krize. Dhe çdo ditë kishte nga një stuhi në Kosovë. Përditë ai ishte në një farë mënyre shkëmbi në kohë stuhish. Gjenerata e re ishte kundër tij në Kosovë, sepse ata ishin luftëtarët e lirisë, por Rugova këmbëngulte në mjetet paqësore. Për Rugovën ishte gjithnjë e

mundur që të debatohej, dhe me të gjithë, përfshirë edhe armiq të tij. Dhe ishte gjithnjë më e thjeshtë të debatohej me zotit Ibrahim Rugova dhe ta bindje atë në emër të UNMIK-ut që unë drejtoja që të ecte në rrugën e paqes dhe në mënyrë të veçantë për të mbrojtur pakicat në Kosovë. Ne nuk arritëm sukses në këtë drejtim. Megjithatë Rugova ishte një aleat i vërtetë për të siguruar mbrojtje për këta njerëz. **BBC:** A ka qenë ndonjëherë e vështirë të punoje me zotit Rugova? **Kouchner:** Patjetër, që ishte e vështirë, sepse edhe pse ishte një pacifist i vërtetë, ai ishte në favor 100 për qind të pavarësisë për Kosovën. Dhe për ne, dhe mua që më duhej zbatimi i rezolutës 1244, ishte e vështirë të ishim në favor të pavarësisë. Luftëtarët e lirisë ishin gjithashtu për të. Për ne ishte shumë e vështirë që ta bindnim zotit Rugova në shumë raste. **BBC:** A mund të na tregoni ndonje episod që e ilustron këtë që thatë? **Kouchner:** Më kujtohet një mbrëmje shumë e vështirë në shtëpinë time. Ishim ne të tre; Hashim Thaçi lideri i UÇK-së, zoti Rugova dhe unë. Unë doja t'i bindja ata që të bëheshin që të dy anëtarë të ashtuquajturit organi qeverisës i përkohshëm që inicohej nga UNMIK-u. Sepse atë kohë kishim tre qeveri të UNMIK-un. Pra na duhej të drejtonim një organ të vetëm. Pas orëve të tëra debatesh, Ibrahim Rugova pranoi dhe më pas edhe zoti Thaçi. Trurojet e tyre ishin jashtë shtëpisë sime dhe po grindeshin me njëri-tjetrin në kopësht dhe në rrugë. Ajo natë ishte shumë e vështirë, por që një moment vendimtar. **BBC:** Zoti Kouchner ajo natë që vendimtare, sikurse edhe prania e zotit Rugova në atë bisede, por çdo do të thotë mungesa e tij në lidhshimin kosovar dhe në vetë jetën politike të Kosovës? **Kouchner:** Unë besoj se ka lënë një dhembje të madhe. Por unë kam bindjen se nëse ai ka qenë një person magnetik, nëse ai ka qenë brilant dhe karizmatik (dhe kjo ka ardhur prej personalitetit të tij mjaft të vendosur) jam i bindur se kjo do të përcillet tek gjenerata e ardhshme.




## Evropa kujton rezistencën paqësore të Rugovës

Gazeta franceze **LE MONDE** i hedh një vështrim të ardhmes së Kosovës pas vdekjes së udhëheqësit të saj Ibrahim Rugova. "Pacifisti shqiptar", i cili vdiq pak ditë para fillimit të negociatave midis Beogradit dhe Prishtinës për statusin e Kosovës, "nuk pati kohë të hiqte shallin e kuq që ai kishte premtuar ta hiqte vetëm kur vendi do të bëhej i pavarur," shkruan gazeta. "Kosova mbetet një qëndër mungese qendrueshmërie," vë në dukje ajo. "Kushtetuta është e përkohshme, pakica serbe është e kufizuar në enklava dhe konsiderohet si armike, ose të paktën si alibi që e lejon Beogradin të pretendojë të drejtën e tij," shpjegon gazeta. Për sa i përket ekonomisë, "ajo është e subvencionuar nga bashkësia ndërkombëtare," shton ajo. Po, shton gazeta, gjendja nuk është aq e keqe sa duket. "Gjatë betejës së udhëhequr nga zoti Rugova dhe Lidhja e tij Demokratike e Kosovës, populli i Kosovës ka arritur maturi të vërtetë politike," shkruan ajo. Që nga fundi i luftës, "pa hequr dorë ndonjëherë nga ëndra e tyre për pavarësi, ata kanë votuar gjithnjë për pacifizëm dhe durim," shkruan gazeta franceze. Gazeta gjermane **FRANKFURTER ALLGEMEINE ZEITUNG** shkruan se çështja se kush do ta pasojë zotit Rugova do të vërë në provë demokracinë në Kosovë. Gazeta shprehet së mënyra se si "do të kryhet kjo luftë për pushtet" është më e rëndësishme se sa kush e fiton atë. "A do të provojë sistemi demokratik i Kosovës se është i qëndrueshëm në masë të pranueshme? ngre pyetjen gazeta. Gazeta tjetër gjermane **FRANKFURTER RUNDSCHAU** shkruan se BE-ja do të duhet të luajë një rol aktiv në Kosovë edhe për shumë vite të tjera. Gazeta argumenton se bashkësia ndërkombëtare nuk duhet të pranojë një ndarje të Kosovës sipas vijave etnike sepse "kjo do të minonte përpjekjet ndërkombëtare gjatë viteve të fundit për një Kosovë shumëetnike." "Si do që të duket zgjidhja pas negociatash të durueshme, është e qartë se bashkësia ndërkombëtare, ndoshta në formën e BE-së, do të duhet të përgatitet për një lloj roli kujdestar në Kosovë edhe për shumë vite," shkruan gazeta gjermane. Gazeta austriake **DER STANDARD** shpreh frikën se vdekja e zotit Rugova ka krijuar një "vakum të rrezikshëm pushteti". "Për bisedimet e statusit ai kishte transmetuar një ndjenjë drejtimi dhe vetbesimi në vend dhe besueshmëri jashtë," shkruan gazeta. "Kjo tani nuk ndodh më," shkruan gazeta. Ajo beson se pa zotit Rugova do të jetë më e vështirë për të shitur idenë se pavarësia e kufizuar me të drejta të mëdha për serbët e Kosovës është "më e mira që mund të arrihet për shqiptarët e Kosovës." Me këtë ide bashkohet


edhe gazeta britanike **THE DAILY TELEGRAPH** e cila shkruan se ndërsa kosovarët po mbajnë zi për vdekjen e presidentit të tyre, kanë filluar përpjekjet për gjetjen e një pasuesi "për të mbushur vakumin e lënë nga një figurë e fuqishme në negociatat e pavarësisë". Gazeta citon kreun e administratës së OKB-së në Kosovë Soren Jessen-Petersen që bën thirrje për unitet para bisedimeve me Serbinë, të cilat janë shtyrë për nga fillimi i shkurtit. "Qëllimi të cilit ai i dedikoi jetën e tij ishte një Kosovë e lirë," citohej të ketë thënë Petersen gjatë një mbledhjeje të parlamentit në kujtim të Rugovës. Gazeta thotë se aleati i Rugovës, Nexhat Daci, kryetar i parlamentit, është ngarkuar me detyrën e presidentit dhe shton se zoti Daci është një nga kandidatët për postin, që duhet mbushur brenda tre muajsh. "Mbështetësit perëndimorë dëshirojnë që Lidhja Demokratike e Kosovës e Rugovës ta mbushë këtë boshllëk më shpejt." Gazeta tjetër britanike **THE INDEPENDENT** shkruan se në Kosovë kanë filluar seriozish përpjekjet për të gjetur një udhëheqës tjetër për të drejtuar drejt pavarësisë, pas vdekjes "së udhëheqësit ikonë". Gazeta shkruan se Rugova është njohur si "Gandi i Ballkanit, për shkak të strategjisë së tij të rezistencës paqësore". "E ardhmja e Kosovës varet në ekujlibër pas vdekjes së zotit Rugova," shkruan gazeta britanike **THE GUARDIAN**, në një shkrim nën një foto të madhe të një posterit me foton e zotit Rugova. "Rugova," shkruan gazeta, "është gati e pamundur të zëvendësohet". Ai ka qenë udhëheqësi për rreth 20 vjet i përpjekjeve për pavarësi. Gazeta thotë se bashkësia ndërkombëtare është e një mendjeje se vdekja e tij "nuk duhet lejuar të pengojë procesin drejt zgjidhjes." "Presidenti Rugova ishte njeri i paqes, i vendosur përballë shtypjes, por i angazhuar thellë në idealet e mosdhunës," shkruan gazeta britanike. Gazeta **FINANCIAL TIMES** e titullion lajmin për Kosovën: "OKB-ja bën thirrje për qetësi pas vdekjes së udhëheqësit të Kosovës". Bashkësia ndërkombëtare, shkruan gazeta, është e shqetësuar se, megjithëse vdekja e zotit Rugova nuk ishte e papritur, ajo mund të pasohet nga debate midis udhëheqësve kosovarë dhe ndoshta mund të nxisë tensione midis shumicës shqiptare dhe pakicës serbe. "Zoti Rugova nuk jetoi për të parë përmbushjen e ëndrës së tij për një pavarësi të Kosovës," shkruan gazeta. "Por ai jetoi aq sa të shikonte fillimin e procesit diplomatik që mund të çojë në deklarimin e ndonjë forme të

**H**istoria ka provuar shpesh se si fshehja pas një historik mund ta lere një shoqëri në miopi përpara realitetit e kjo mund të rezultojë e demshme, në mos e rrezikshme. Kjo ndodh veçanërisht kur mitet humbasin aktualitetin e tyre, apo kur nga një forcë frymëzuese, përbashkuese e identitetdhënëse kthehen në simbole pushteti që vjen duke u degraduar, por edhe, - madje do të thoja mbi të gjitha, - kur shoqëria nuk zhvillon instrumentet e njohjes me sy kritik të historisë dhe të zhvillimeve të saj. Shembujt janë të shumtë si në historinë botërore, ashtu edhe në historinë shqiptare. Historiani Bernd Fischer kur flet për mitizimin e Luftës së Vlores nga Zogu dhe propaganda e tij thotë se veshtrimi i italianëve me syrin e ketij miti, pra duke i nënvlehtësuar ata, dhe mosnjohja e realitetit se nuk qenë shqiptarët që "hodhën në det" ushtrinë e një fuqie të madhe, por rrethanat historike që e detyruan këtë të largohet, ndikoi që Shqipëria të humbase shumë lehtë pavaresinë me 1939. Një mit historik që duhej parë me kujdes në këtë kontekst e duhet zberthyer në të mirë të njohjes së realitetit është ai i tolerancës fetare midis shqiptarëve. Pas rënies së komunizmit ky ka qenë një nga shtyllat e forta të vetmburrjes së shqiptarëve. Aq sa Presidenti ynë ka arritur ta quajë, se fundi, në fjalimin e tij të famshëm në Oxford: "një tipar etnotipik të shqiptarëve", "një traditë që vjen nga thellesia e shekujve" që "nuk është zhvilluar në kohët moderne", por që "ka ekzistuar madje edhe para shfaqjes së faktorit osman" dhe ta paraqesë si guri i çmuar që në mund të i paraqesim Perëndimit për të na pranuar në komunitetin e vet: "toleranca nderfetare ishte një prej çësjeve që terhoqi menjëherë vëmendjen dashamirëse të të gjithë atyre dijetarëve dhe politikaneve, shqiptarë e të huaj, që besonin dhe kërkonin tek populli shqiptar një imazh tjetër." Po të gërmojmë vetëm pak me thellë me sy kritik do të veme re se tërë keto që citova më lart nuk janë tjetër veçse shfaqje e kultures së fshehjes së struci për realitetin. Mjafton për këtë ta ballafaqojmë realitetin historik shqiptar me disa pyetje të thjeshta që kanë të bëjnë me thelbin e tolerancës. Pyetja e parë është: nëse me tolerancë do të kuptojmë pranimin e tjetrit të ndryshëm, atëherë si ka mundësi që shqiptarët kanë qenë kaq intolerantë ndaj njeri-tjetrit të ndryshëm, sa që ndëruan regjimin me totalitar në Evropën e pas Luftës së Dytë? Si ka mundësi që arriten të i mbyllin krejt kishat dhe xhamitë, nderkohe që vendet e tjera komuniste nuk arriten deri këtu? Dhe, për t'u afruar në kohë: si është e mundur që edhe sot e kësaj dite tregojnë një intolerancë të jashtëzakonshme ndaj njeri-tjetrit - po të kesh parasysh marrëdhëniet pushtet opozite psh., por jo vetëm? Ka një paradoks këtu: një popull që e ka tolerancën tipar "etnotipik" "shekullor" tregohet kaq intolerant. Dhe paradokset kërkojnë shpjegim. Pa dyshim po të perpiqemi t'i japim një shpjegim racional ketij paradoksi do të vijmë në përfundimin se ajo që e quajmë "tolerancë fetare" e shqiptarëve nuk është një veti e dhënë njerëzore e përgjithmone, madje as tolerancë në kuptimin e gjere të fjalës, por produkt i kushteve historike të një konteksti të caktuar, madje, ndryshe nga ç'thote Presidenti, kryesisht i kohëve moderne. Nëse do të kërkojmë rrethet e saj në Shqipëri do t'i gjejmë pjesërisht në tolerancën ndaj feve të ndryshme që ka pasur përgjithësisht Perandoria Otomane, pjesë e së cilës shqiptarët e tre feve qenë për 500 vjet, por mbi të gjitha ato do t'i gjejmë si produkt i periudhës kur lindi nevoja e ngjizjes së shtetit kombëtar në Shqipëri, dmth. në kapërcyell të shekullit XIX, kur feja laike e kombit u bë mbizotëruese mbi fe të tradicionale sepse, përndryshe, keto do të pengonin procesin e kombformimit. Që këtë edhe thenia e famshme (intolerante) e Pashko Vases, njëherësh i krishterë dhe pasha otoman, "mos veshtroni kisha e xhamia, feja e shqiptarit është shqiptaria." Gje që në vendet e tjera rreth nesh nuk ndodhi, sepse feja u bë faktor identiteti kombëtar për shkak se mbizotëronte një fe e vetme. Këtu na duhet të bëjmë një saktësim persë i perket konceptit të tolerancës. Ai historikisht ka burim fetar dhe nënkupton një komunitet fetar superior në numrin e besimtarëve, mbi të gjitha në pushtet, që toleron një komunitet tjetër inferior. Ky ka qenë në Francë rasti i tolerimit të protestanteve nga Henriku IV (Edikti i Nantes, 1598), i cili toleroi ushtrimin e fese protestante, gjithë duke shpallur katolicizmin si fe shtetërore. Pra është një koncept që nënkupton një superior që toleron inferiorin, që ve gjithashtu një prag mbi të cilin nuk toleron. Madje, sipas filozofit frëng Derrida, termi "tolerancë" jo rastësisht është marrë nga biologjia, sepse nënkupton edhe asimilimin (e inferiorit nga superior). Pra, nëse gjatë periudhës otomane ka pasur tolerancë të pushtetit otoman me fe muslimane ndaj të krishterëve (kjo nuk ka qenë gjithmone kështu dhe, po të kërkojmë në historinë e shqiptarëve të asaj kohe, do të gjejmë raste të tmerrshme intolerancë të shqiptarëve muslimanë të



Fatos Lubonja:

## A mjafton miti i "Tolerances fetare"



pushtetshëm ndaj shqiptarëve të krishterë psh.). Kurse në periudhën e formimit të shtetit shqiptar me shumë sesa për tolerancë, mund të flitet për bashkëzotëse relativisht në paqe midis komuniteteve me fe të ndryshme. Kjo, siç e thamë, kryesisht në sajë të dominimit të fese së ndërtimit të shtetit kombëtar "shqiptarise", e me pas të ideologjisë së komunizmit, mbi fe të tradicionale. Nderkaq fakti që ideologjia e shqiptarise dhe mbi të gjitha ajo e Enver Hoxhës nuk arriti të bashkëtojë në harmoni me fe të tjera tradicionale, nuk është aspak shenjë tolerancë, përkundrazi është shenjë intolerancë. Për komunizmin shqiptar, madje, mund të thuhet se vuri një prag thuajse zero tolerancë ndaj të tjerëve që nuk mendonin si ai. Prandaj t'u flasësh evropianëve për tolerancë në paska ekzistuar nder shqiptarët edhe para Ediktit të Nantes, me synim që të ndërrosh imazhin, do të thote thirrja për bashkësi të qeshin. Nuk do shumë, pra, për të kuptuar se çfarë është tolerancë fetare në Shqipëri nuk janë bërë motiv konfliktesh. Tolerancë jo për ndonjë veti "shekullore" të shoqërisë, por sepse feja nuk ka qenë instrument pushteteshëm në Shqipëri, pasi instrumenti ideologjik i pushtetit është një tjetër fe/ideologji. E këtu vijmë tek problemi i motivit i ketij shkrimi: Sikur pra, të krijoheshin kushte të favorshme ku perkatesia fetare të kishte ndikim në pushtet, atëherë, sikur ka ndodhur në bote, mjafton të kesh parasysh se është rritur instrumentalizimi i fese nga politika dhe shteti arabe njëzet vjetet e fundit, (por edhe amerikane), të cilat, duke qendruar të strehuar si struci në mitin e tolerancës fetare, do të ndesheshim me situata ndaj të cilave do të gjendeshim të papërgatitur. Çka shkrova më sipër për shkak shkas nga konstatimi i një numri incidentesh të shtetit në Shqipëri dhe të tentativave të mbylljes së tyre, të cilat duke përmendur të mirënjohurën traditë të tolerancës fetare si dhe, shpesh, nepermjet veshjes së shkakut të tolerancës

te jashtëm". I fundit është ai i Bushatit kur një kryq i madh i vene mbi një koder është sharruar natën, dhe gjithshka u tentua të mbyllet duke përmendur traditën e mire si dhe duke ia faturuar, siç shkruhej në ndonjë gazetë, serbit, jo muslimanëve shqiptarë. Duke treguar, pra, persëri, gatishmerinë tone për t'i ikur realitetit në vend se sa për ta përballuar atë në kontekstet e reja fetare dhe nderfetare që janë krijuar në vend. Me këtë nuk dua asses të them se nuk duhet përmendur kjo traditë. As se duhet mohuar vlera e saj. Por, se pari, se duhet kuptuar me frymën kritike të kohës historia e saj, pasi vetëm kjo mund të na bëjë të aftë për të kuptuar drejtë të tashmen e për të projektuar të ardhmen dhe, se dyti, sepse miti i tolerancës nuk mjafton për t'u përgjigjur realiteteve të sotme ashtu sikurse nuk mjafton sot t'u thuash shqiptarëve: "mos veshtroni kisha e xhamia, feja e shqiptarit është shqiptaria". Ashtu sikurse nuk mjaftoi dje propaganda e regjimit komunist që, ndonëse u foli shqiptarëve për 50 vjet për dashurinë dhe sakrificat për atdheun, i pa ata të ikën me vrap jashtë atdheut sapo iu dha rasti i parë i hapjes së kufijve. Jacques Derrida, kur trajton problemin e mprehtë të sfidave evropiane me emigrantet e shumë muslimanë që e popullojnë sot Evropën, e atakon konceptin e tolerancës, sikurse e thamë edhe më lart, si një koncept që nënkupton superioritetin dhe asimilimin duke kërkuar që evropianët të zëvendësojnë atë me konceptin e "mikpritjes së pakushtëzuar" me çka kupton pranimin e tjetrit me kulturën e tij. Këtu ai e konsideron sfidën e rradsës që ka Evropa përpara. Është një shembull se si kohe të reja kërkojnë ide të reja dhe idete e reja prodhojnë kohe të reja. Prandaj më do të mendoj se në trajtimin e fenomeneve nderfetare që vihen re sot, siç janë vendosjet e kryqëve apo ndërtime të xhamive në vende sfiduese për besimtarët e tjerë, apo të tjerë akte që reflektojnë qëndrimin anti të krishterë apo islamofobike nuk duhen injoruar disa faktorë të rëndësishëm të periudhës paskomuniste, kombëtare dhe nderkombëtare. Në nivel kombëtar, kemi përjetuar dhe po përjetojmë krizat morale dhe të identitetit që ka krijuar rënia e komunizmit çka shumë njerëz i ka çuar tek feja si kërkim shprese dhe identiteti. Krahas kësaj kemi përjetuar ringjalljen e komuniteteve fetare, çka midis të tjerash nënkupton se keto nuk mund të lihen të marginalizuar apo të injoruar, si më parë, se roli i tyre në rimëkëmbjen morale dhe shpirtërore të vendit duhet të bëhet pjesë integrale e rimëkëmbjes së tërë shoqërisë. Pa harruar nga ana tjetër se ky është një terren shumë i favorshëm për instrumentalizimin e fese dhe se nuk kanë munguar dhe nuk mungojnë tentativa të ketij instrumentalizimi, duke arritur deri në shprehje të demonizimit të njerit apo tjetrit komunitet apo të perçaktimit të cila duhet të jete feja e parë e shqiptarëve. Të mos harrojmë gjithashtu se po përjetojmë një mosshkollim e kriminalizim të frikshëm të shoqërisë, përballe të cilit qëndron një klasë politike thellesisht imorale dhe e korruptuar. T'i lesh njerezit për të injorancës, krimin, varferisë, imoralitetit dhe të shpresosh se ata, megjithatë, nuk do të behen bisha ndaj njeri-tjetrit pasi ti u përmend nate e dite se ata kanë qenë gjithnjë të urtë e të bindur është një iluzion që mund të ketë pasojat e rrezikshme. Këtyre u duhet shtuar në nivel nderkombëtar fakti se përgjithësisht përjetojmë rigjallërimin e feve në bote në këtë periudhë pasmoderne dhe pas 11 shtatorit, që ka shtuar ndjeshëm fenomenin e instrumentalizimit të feve për qëllime politike, që ka nxjerrë në pah shqetësueshmë rrezikun e kundërvënies bote e krishterë - bote muslimanë. Prandaj ngulmoj se ruajtja e frymës shekullore dhe ekumenike të Shqipërisë duhet parë si një sfidë e vazhdueshme që duhet t'i përgjigjet konteksteve të reja të krijuara si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel nderkombëtar dhe jo duke u strehuar në traditën nacionaliste të një shekulli më parë, apo, edhe në legj, në ate totalitare komuniste.

## NJOFTIM

Kush ka nevojë për t'u vizituar dhe kuruar nga sëmundjet kardiovaskulare, onkologjike, gjinekologjike, ortopedike, të diabetit, të syve, vesheve, stomakut, mëlçisë dhe operacione të ndryshme në Stamboll të

— F o t o : —  
**"MANGALEMI"**

Vëllezërit Nasi & Mika

**K A F E**

"Çelepias" pranë 6 katëshit...

Tel. 069

2151722

— SHITET NJË SHITËPI —

*Shitet një shtëpi dykatëshe në lagjen  
 "Muzakaj" e përbërë:*

*2 hyrje, 7 dhoma, 2 mjedise gatimi, 3 banjo,  
 ballkon, verandë, oborr, parking,  
 kopësht me pemë.*

Tel: 032 32 638

MINI MARKET-USHQIMORE-BULMETORE  
 ËMBËLTORE

**"ALUSH QERESHNIKU"**

Në dyqanin tonë do të gjeni: 80  
 lloje verërash. Të gjitha verërat e  
 Beratit.

P A I S J E  
 H I D R O S A N I T A R E  
**Dyqani i Shpatës**

Adresa: AXHENSIA

TEL: 068 27 03 384 (ILIA)

Artikuj shkollorë zyre  
 fotokopje, shtypshkrime, plastifikuese,  
 punë kompjuteri.  
**INTERSIG.**

Adresa: Ngjitur me postën qendrore

FERDINAND KADIFEJA

Tel: 32 246

**S h u m i c a**  
**U s h q i m o r e**  
**Tek Axhensia**

**Rexhep Arza**

**Okazion**

*Shiten makina qepse për lëkurë dhe  
 këpucë, shitet lëkurë dhe copa lëkure.  
 Shiten paisje të ndryshme.*

Tel: 069 22 082 72

**Steku**



**Ndërtime**

Pronar: Nexhmedin Pulake  
 Tel: 069 20 96 191

**Jon Impex**


Agjensi transporti ndërkombëtar udhëtarësh  
 Bileta autobusi për Greqi (Janinë- Rio- Athinë)  
 Bileta trageti për Itali  
 Bileta avioni

Tel. 032 31 565

Cel: 068 22 63 650

Lagja: "22 Tetori" pranë Bar "Prince"

## Qytetit tim



Qyteti im!

Ç'të ka rënë sot ky nur?

Është malli, të shoh pas kaq vitësh.

Po më dukesh më i bukur se kurrë.

Shtëpitë e ndërtuara njëra mbi tjetrën,  
Që asnjë piktor s'do t'i vendoste dot aq bukur.  
Unë piktor dua të bëhem për ty sot,  
Në telajo të hedh mallin e pashuar...

Dua të pi pak ujë Bogove,  
Ajrin e pastër të pishave të thith.  
Të shoh diellin n'agim kur del mbi Tomor,  
Të udhëtoj me linjën urban Kombinat - Uznovë.

Erdha tek ti, qyteti im!  
Këto rrugica të shtruara me kalldrëm  
Më çojnë në të largëtën fëmijëri.  
Nuk u çmallkam dot me ty  
Dhe pse i puth të gjithë e qaj si fëmijë.

Erdha tek ti qyteti im,  
Tek ju, o njerëz të mirë e të dashur.  
Tek ti vendlindja ime jam tani,  
Ju, përherë mall e dashuri më keni falur...

Vetë natyrës i ke marrë  
Gjithë këtë bukuri të rrallë.  
Po mua vallë ç'do më japësh  
Të më shuaj sado pak këtë mall?!

Do marrë pak ujë të ftoht Bogove,  
Si ujin e bekuar në shtëpi 'a mbaj.  
Me pikatore ta pi, etjen të më shuaj,  
Mallin për Beratin do mundet dot vallë?

Do marrë një gur nga kalldrëmi,  
Nga ajo rrugicë ku hodha hapin e parë.  
Një degë pishe nga Mali i Goricës,  
Ngado që të shkoj, me vete ta mbaj.

Kam shumë vjetë i mërguar.  
S'më dëbove, u largova.  
U enda shteteve në tokë të huaj,  
I përbuzur, i pangrënë, i skllavëruar.

Berat! Je djali i Evropës,  
Shpirti që më jep frymë je ti, më mban gjallë.  
Amerika dhe Evropa,  
Je vetë ti, o i bukur Berati.

Malli i zjarrit që digjet në vite.  
Mallin nuk e qetëson as gjumi.  
Sikur Tomori të shkrihej e bashk'ëme Osumin,  
Mallin s'do mundeshin dot ta shuanin!

S'qenka e lehte te ndahesh nga qyteti,  
Qe tridhjetë vjet më mbajti ne gj.  
Vij nga udhë e gjatë kurbeti,  
Më beso, do kthehem përsëri.

Dhe kur një ditë vdekja të trokasë,  
Nuk dua që shpirti të më dalë në tokë të huaj.  
Pranë varreve të prindërve të mi dua të prehem,  
Dheu i tokës mëmë të më tresë, dua...

Pierre-Pandeli Simsia  
New York, USA

## Floresha Debinja, bilbili i këngës qytetare beratase

Dikur ishte një vajze e re, punetore në Kombinatin e Tekstileve në Berat. Ndersa nga duart e saja të brishta dilnin prodhimet e bukura shumëngjyreshe, në thellesinë e shpirtit të saj vlonte një zjarr. Ishte zjarri i këngës.

Vajza e druajtur nuk mund të rrinte pa kënduar edhe kur qendronte mbi makinën e saj të punës. Zeri i saj i embel si kanarine, sikur nuk i shkonte t'i fshihej karakterit të saj të druajtur. Kerkonte të shperthente, të dilte nga ai kraharor i asaj vajze që kishte lindur për t'i kënduar vendit të saj, popullit të saj.

Në dhjetorin e vitit 1974 do të ngjitej për herë të parë në skenën e Festivalit të 13-të të Këngës në Radiotelevizion për të kënduar këngen: "Syrin pishe, zemren barot", e kompozuar kjo këngë nga Kristo Kote. Ky do ishte dhe fillimi i saj për t'u ngjitur në rrugën e gjatë e të bukur, në artin e të kënduarit.

"Ju keni një këngëtare e madhe" do të thoshin në Shkodër a në Gjirokastrë, nese dikush prezantohej nga Berati dhe beratit do ndjeheshin kërenare për këngëtarën e tyre që ishte bërë aq e njohur. Floresha Debinja!


Kush nuk e degjon këte emer edhe sot e të mos t'i tingellojnë ende të fresketa këngët e bukura qytetare beratase, që mjeshtria e këngës Floresha me zerin e saj të embel i çoi në çdo familje. "Çupe, thyej ato gjilpera", "Trendafilin i bukur shumë", "Kur keputa borzilokun", "Kur hyn në Mangalem" e shumë e shumë të tjera, kush nuk i degjoi dhe nuk u dashurua pas zërit të saj të embel.

Nuk ka shtëpi, jo vetëm në Berat, por në gjithë Shqipërinë ku të mos këte hyre zeri i saj i embel e melodioz dhe Floresha bashkë me tingujt e saj do t'u dhuronte emocione të shumta gjithë atyre që i adhuronin këngët e saja popullore.

Për shumë vite këngëtare e estrades profesioniste të qytetit të Beratit, pjesëmarrëse e shumë festivaleve të këngës popullore si edhe e festivaleve të këngës në qytetin e Beratit, do ta çonte zerin e saj edhe atje, ku e kerkonte vete jeta, pranë bujkut në are, tek perurohej një lapidar deshmore apo inagurohej një fabrike, në repartet ushtarake pranë ushtareve.

Si bije e Beratit, ketij qyteti djep i kultures se lashte, aq sa ishte vete lashtesia e tij mbi 2400- vjeçare Floresha Debinja i erdhi në kohe qytetit të saj, për të kënduar folklorin e tij të pasur e të pashtershem, ashtu siç e kanë kënduar paraardhësit e saja, Virginia Mile, Hyrije Saraci.

Perkrah vellezerve Dhimiter e Kozma Dushi, Ludmilla Baballeku, duke punuar për vite me radhe me ata, do ta çonte këngen qytetare beratase edhe atje, larg atdheut, ku ndodheshin bashkatdhetarët e saja, në mergim jashtë Shqipërisë me ansamblet popullore "Tomori" dhe "Myzeqeja", ku do jepnin koncertet e tyre të suksesshme, duke u çuar bashkatdhetarëve një pjesë të munguar nga atdheu i tyre, këngen e bukur popullore shqiptare.



Floresha i erdhi Beratit në atë kohe, kur Kuçedra Komuniste i kishte shtrire kthetrat e saja edhe në art, atehere kur populli jetonte kohën e ushqimit me tollona dhe kënga e saj do "ushqente" shpirtin e atij populli me zerin e saj të embel dhe Berati do dinte si t'ia shperblente, duke e quajtur: "Bilbili i këngëve" të tij.

Për formimin e saj si këngëtare një pune të madhe ka bërë edhe drejtuesi i orkestres së estrades së Beratit, kompozitori, Artisti i Merituar Sotiraj Konci, i cili nuk do gabonte në zgjedhjen e tij për të punuar vite e vite me radhe me Floreshën. Gjithashtu një pune të palodheshme kanë bërë edhe drejtuesi i grupit karakteristik të këngës, i paharuari Asqeri Kadena dhe Teki Luari.

Në vitet e veshtira të tranzicionit Floresha është e vetmja artiste që nuk u largua nga vendi i saj, Shqipëria.

"Kam lindur e jam lindur në Berat, i kam kënduar popullit dhe qytetit tim dhe Beratin nuk mund ta gjej kurrë ngado që të shkoj...", do t'i pergjigjej këngëtarja atyre që do t'i ofronin një shtetëtim jashtë Shqipërisë.

Këngët e saja të kënduara ndër vite janë e vetmja pasuri e saja që Floresha ka ditur të prodhojë e ta shperndajë këte pasuri në popull.

Floresha Debinja nuk mban ndonjë titull zyrtar nga ndonjë institucion kulturor shtetëror. Vlerësimi i madh që populli i saj i ka dhënë e i jep, respektin dhe dashurinë, mirënjohjen për gjithshka ajo ka bërë gjatë karrierës së saj si këngëtare, është me shumë se Artisti i Merituar, pse jo dhe Qytetare Nderi e Qytetit të Beratit.

Këngët e bukura që ajo këndon me aq ndjenjë, zjarr e mjeshtëri e kanë bërë këngëtarën Floresha Debinja të quhet "Mbreterësha e këngës qytetare Beratase".

Pierre-Pandeli Simsia, Nju Jork

### Ndreqje gabimi


Në gazetën "Lajmëtari", ditën e hënë, datë 23 janar 2006, në faqen 5, shkruam me titull "Busulla e jetës sonë", gabimisht i është vënë emri i zotit Bujar Orizaj, kurse autore e shkrimit është zonjusha Monika Melëngu. I kërkojmë ndjesë lexuesve si dhe zonjushës Monika Melëngu, nga e cila presim bashkëpunim të vazhdueshëm.

Gazeta "Lajmëtari"

### Vezhgim

## NJË GOMONE PËR NË PROKURORI


Nuk është fjala për banorët e zonës së përtejme të komunave Terpan dhe Starovë, të cilat me qytetin dhe prokurorin e rrethit i ndanë lumi Osum dhe që të vijnë më shpejt mund të përdorin një gomone. Fjala është për të gjithë qytetarët e Beratit që duan të shkojnë në prokurorin e rrethit, e cila ndodhet në qendër të qytetit, në lagjen "30-vjetori". Liqeni artificial që është krijuar përpara portës hyrëse për në prokurori si



shkak i një grope të madhe të mbushur me ujë, shumë qytetarë i detyron që të kthehen mbrapsht dhe, pasi ata të kenë gjetur një palë çizme, mund të hyjnë në institucionin e drejtësisë. Tashmë ky liqen këtu nuk është i pranishëm vetëm në ditët me shi, për shkak të thellesisë së gropës

ai tani është i pranishëm edhe në ditët me diell, duke krijuar kështu edhe një "vend punë" për të papunët e shumë të që numëron qyteti -muze i "një mijë dritareve". Liqeni artificial përpara prokurorisë së rrethit është një "bukuri" që i mungonte qytetit.

A.K.



Stavri Bobo

# Tradita e këngës në familjen Saraçi

Kënga popullore qytetare në këtë familje vjen e hershme qysh në shekullin e kaluar. Në vitet '20 shumë beratas shkonin për tregti në qytetet kosovare. Viti 1937, lidhi në miqësi Xhemil Saraçin dhe disa beratas, shokë të tij, me tregtarë prizrenas. Njëherë, pasi kishin mbaruar punët e tyre, në një darkë të shtruar për ta, beratasit ia morën këngës. Xhemili këndonte bukur. Kjo i befaso. Ishte qytetaria dhe miqësia e këngës që mbajti Xhemalin për disa ditë të tjera midis kosovarëve.

Xhemil Saraçi lindi në qytetin e këngës, në Berat, më 25.11.1916, në Muratçelepias dhe vdiq më 1985. Qysh në moshë të re dallohej për zërin e tij. Aty rreth vitit 1938 te kazinoja e Dardhanjakëve (ku është sot klubi i ditëve tona "Dardha"), mbledhje me shokë dhe ia niste këngës popullore qytetare. Ahengu bëhej i madh. Zëri i bukur i Xhemilit kumbonte. Goricarët sa dëgjonin ahengun, duke qenë qejflinj, kalonin lumin dhe vinin në kazino. Vetëm e vetëm të ishin të pranishëm e të dëgjonin Xhemil Saraçin kur këndonte.

Aty nga viti 1940, kur ishte në Tiranë për punë, në mbrëmje ulej me shokë në kazino për t'u çlodhur. Pasi pinin nga një gotë, Xhemili niste këngën popullore beratase. Zëri i tij i bukur bënte që të mbledheshin mjaft njerëz, aty dhe bejlerë. Ka ndodhur njëherë që Xhemili nuk ndodhej një mbrëmje. Një nga bejlerët i thotë sejmeneve të tij: "Të gjeni Xhemilin që të këndojë për pres. Në qoftë se nuk është në kazino, do ta vras".

Ky ishte Xhemil Saraçi, këngës popullore, për


të cilin nuk rrinin dot pa i dëgjuar zërin e tij të ëmbël.

Në vitin 1950, me krijimin e fabrikës së këpucëve në Tiranë, si gjithë specialistët e tjerë këpucarë merret në punë dhe Xhemil Saraçi. Ai pas punës shkonte me shokët beratas në klub për t'u çlodhur. Ata bëheshin një dorë e mirë dhe këndonin. Ata i bashkonte kënga popullore, zëri i bukur i Xhemil Saraçit. Gjithë fabrika gumëzhinte për Xhemilin. Këtu në këtë fabrikë, Xhemili njohu Gjylën, nga Veriu, që banonte me prindërit në Tiranë. Ajo u dashurua pas Xhemilit, sikundër dhe ai me të. Me dëshirën e saj Xhemili e merr dhe e çon në familje Gjylën, e cila ka pesë fëmijë. Gjyja ishte e dhënë pas këngëve popullore, ashtu si dhe Xhemili.


Dy vëllezërit e tjerë të Xhemilit, Shpëtimi dhe Novruzi (Nokja), ishin këngëtarë popullore. Zëri i bukur i tyre në gëzimet familjare, dasma ose, në tryeza shoqërore i jepnin kënaqësi gëzimeve.

Xhemili sa herë që kthehej në mbrëmje në shtëpi, së bashku me Gjylen, këndonte këngë të bukura qytetare beratase.

Fëmijët e tjerë, Hyrija, Afrimi, Gëzimi, Zamiri, të cilëve u pëlqente kënga popullore, u luteshin prindërve ta përsërisin edhe njëherë këngën. Ata e dëgjonin me shumë kënaqësi si dhe vazhdonin t'i shoqëronin duke kënduar së bashku si një miniansambël popullor i vërtetë. Kjo familje duke patur prindërit këngëtarë, tradita e bukur e të kënduarit iu transmetua fëmijëve.



Xhemil Saraçi



Hyrie Saraçi

Zërin e bukur të popullor beratase, para prindërve e trashëgoi bashkëqytetarëve, në edhe vajza e tyre Hyria. qytetet të tjera të Hyria u ngjiti në vendit si dhe jashtë skenë me këngën kufijve, duke i bërë

jehonë këngës së qytetit të lindjes.

Lindi më 10.12.1951 në lagjen Muratçelepi. Qysh e vogël ajo kishte dëshirë të këndonte. Kur këndonin prindërit, ajo këndonte bashkë me vëllezërit e saj që e shoqëronin. Prindërit shikonin te vajza e tyre, e cila kishte një zë të ëmbël e tërheqës, se mund të bëhej një këngëtare e mirë. Në moshën 7 vjeç, që në klasën e parë të shkollës "24 Maj" filloi të këndojë. Zërin e saj të ëmbël e spikat mësuesja e saj Liri Kozumi, e cila e aktivizoi si këngëtare me grupin artistik të shkollës. Ajo doli para shkollës për herë të parë me këngën "Një shëndet, një lumturi". Duke parë perspektivën e kësaj vajze, e regjistruan në shtëpinë e pionierit. Në shtëpinë e pionierit Hyria filloi të mësojë mënyrën e të kënduarit. Mjaft këngë ajo arriti t'i realizojë me së miri, megjithëse ishte e vogël në moshë.

Hyrie Saraçi ishte pjesë e shumë festivaleve të fëmijëve. Juria e festivaleve e ka nderuar me çmime Hyrija Saraçin, megjithëse s'ishte veçse 10 vjeçe u ngjiti në skenë, duke qenë tashmë këngëtare e estradës profesioniste të qytetit të Beratit. Hyria po rritej së bashku me këngën. Ajo gjatë gjithë kohës ka kënduar këngë të ndryshme, por në veçanti ka kënduar me shumë dashuri këngët e qytetit të lindjes.

Hyria edhe pse u martua në Tiranë, asnjëherë nuk u nda nga qyteti i saj. Në dekadat e majit, ajo ishte anëtare e ansambllit "Tirana", dhe është paraqitur me këngët qytetare. Është nderuar me çmime të para e të dyta.

Këngëtarja Hyrie Saraçi ka qenë pjesëmarrëse e Festivaleve Folklorike të Gjirokastrës si dhe në festivalin folklorik të zhvilluar në Kalanë e Beratit në shtator të vitit 1995. Ajo është paraqitur për qytetin e Beratit me këngët tradicionale të folklorit beratas. Edhe në

festivalet e këngës popullore të zhvilluara në Elbasan është paraqitur me këngët e qytetit të lindjes si e ftuar. Hyrie Saraçi ishte e pandarë nga aktivitetet e ansambleve që zhvilloheshin. Ajo ishte pjesëmarrëse e grupit artistik popullor të krijuar në 1980 në drejtimin e kompozitorit dhe muzikantit Asqeri Kadëna.

Pasioni, dashuria për këngën qytetare dhe vetë për qytetin e lindjes bëri që të jetë pjesëtare e grupit artistik "Gorica", qysh në koncertet e para, siç janë ato të datës 8.02.03, e shtunë, dhënë në Shtëpinë Qendrore të Ushtrisë në Tiranë për anëtarët e shoqatës "Berati", me rastin e promovimit të librit "Këngët e Beratit", të studiuesit, poetit, shkrimtarit, publicistit Agim Mehqemeja dhe të datës 17.04.03, nga grupi artistik popullor "Gorica" në Berat.

Ajo ka qenë e pandarë nga grupi artistik popullor "Gorica" tashmë "Berati" në koncertin e dhënë në Teatrin e Operas e të Baletit në Tiranë, datë 11.12.03, si dhe në koncertin e dhënë në kalanë e Prizrenit më datën 12.06.2003. Hyrie Saraçi shpalsi në këto koncerte një nivel të lartë artistik.

Si këngëtare me zë ka marrë pjesë në koncertet që janë dhënë jashtë shtetit. Ka bërë albumin e saj të parë me këngët popullore qytetare beratase. Ky album këngësh për Hyrien, ka qenë një detyrim moral për qytetin e saj të lindjes Beratin, ndaj ardashësve beratas që i kanë dhënë duartrokitjet e para. Ajo edhe sot vazhdon të këndojë me dashuri këngën popullore qytetare beratase, për të cilën shprehet: "Sa herë që unë e këndoj kënga popullore, më shton jetë, se te ajo gjej veten, qytetin tim, Beratin.

# Dhimbja e Lokemadhes

(Skicë letrare)

Qenka thinjur brenda një nate Kosova. Brenda disa ditësh. Si një Lokemadhe e heshtur ia paka hapur derën e rëndë vëllezërve për udhëgjatin e kryevëllanë e tyre me një arkëmort të flamurtë në supe. Ani, Prishtina, bash i odës së lirisë e mençurisë! Në këto ditë të ngrira ti paske më tepër frymë rugoviane, mençuri rugoviane, buzëqeshje rugoviane... Po si na iku kështu?! Si?!...

Si maratanomomak që porsa na ka lënë në duar stafetën e mençurisë. Stafetën e valëvitjes së Flamurit. Të një himni që ende s'ia këndoi fjalën e fundit. Iku pa na vënë në krye Kurorën e Festës, Kurorën e Ëndrrës. Ta prekte. Të gëzohej si ai. Të heshtte si ai. Të mendohej si ai. Ta bekonte si ai, i pagjumi, punëshumi, sëmundjeshumi i Kosovës... Iku me një dorë të lodhur nga pena e sëmundja. Iku pa na thënë edhe një fjalë tjetër të pathënë. Si gurët ende të pa vënë në një kështjellë ku ka kështjellarë të pafund. Madje edhe nga ata që lindën në këto ditë erëngrira e mortit. U dashkan të thinjen një çast lulet në palcën plisgjakosur të Rugovës, të Reçakut, të Drenicës për humbjen e bacë Ibrahimit. Dimri paska


shkuar në majën e tij për t'u matur vetëm me veten, por jo për të na mundur. Jooooooo!

I patë varganët e njerëzve? Dikush tha se në Prishtinë, diku pranë Skënderbeut e Nënë Terezës, paska ardhur DETI. Deti i dhimbjes vinte nga Krusha, nga Prizreni e Peja. Nga Vlora e Amerika. Nga Suedia e Tetova. Nga...

E gjërë rruga që i sollti. A nuk ishte çdo trup që përulej dhembshurisht si një lulëkuqe Rugove që aromizonte të nesërmen e Kosovës? I patë ata, të pangopur në Etjen e tij? I patë tek ecnin në hullinë e Fjalës së tij? "E si ta kalojmë këtë Dimër pa na thinjur edhe malet?", thoshin pleqtë. "Po si ta kapërcejmë Ditëngrirën e Mordit?", thoshin nënat. "A do ta bëjmë të qetë gjumin në netët e tjera të ngrira?", thoshin ca të tjerë. Ani. Ani.

- Mbillni një tjetër pishë-flamur në vlagun e shpirtit të kombit! - tha dikush. - Vaditeni me lotin e gazit të së nesërmes që na e mbolli sadopak edhe ai. Unë dhe ju. Ju dhe ata.

Hej, Lokemadhe! Më tepër se ky dimër i ardhur nga Rusia e largët, ta paska ngrirë pak lotin dhimba e arkëmortit të flamurtë të Ibrahim Rugovës. Ta paska thinjur



flokun e bukur! Ta paska kthyer në një tel lahute ku lahutari e ulka kokën si një mal kapuçbardhë e thur eposin më të ri. Eposin më të lashtë. Mbase 100-vjeçar. Mbase 2000-vjeçar. Mbase 3547-vjeçar. Eposin e Mirënjohjes! Eposin e Kujtesës që i bie kabanave të Antiharresës. Ta paska kthyer në udhë, në ugar. Ku plugojnë lavëtarët. e farës së re. Lum ne që s'mbetemi kurrë pa lavëtarë, pa lahutarë, pa poetë. Se lufta me Dimrin e dashka jo vetëm kokrrën e grurit nën dëborë, edhe ylberin që mund Mjegullën, por dhe duart tona që ngatërrohen me plisat e varreve e të luleve e që bëhen vëllamë me qiellin...

Ma çan gjoksin dhimbja jote, moj Lokemadhe! Ma bën më të fortë supin ky vargan burrash, nënash, nusesh, Kjo heshtje fëmijësh që sot kanë marrë moshën e plakut të odës.

T'u ngjatë jeta në breza, o bacë Ibrahim Rugova! Si kalliri që rilind në farën e vogël! Si mollët kokërrmbushura të plakut emërpaharruar që ende vilen nga nipërit e mbesat e vihen gazmueshëm në kokat e të sapomartuarëve. Si këngët e kreshnikëve që ende këndohen në kullat e vjetra e të reja.

Eeeeej, lahutar i lahutës harktendosur! Nise këngën e Rilindjes! Bëje gati kurorën e Ëndrrës! E mos ki droje nga thinjat. Se thinjat ashtu si vijnë, ashtu bredhërojnë sërish larg. Larg. Atje ku një Dimër tjetër nuk i gjen dot as dhe në fund të dheut. Hallall pika e qumështit e mençuria e Lokemadhes, o bacë Ibrahim!

Namik Selmani

## Fletë nga ditari i pashkruar i një mjeku

Ai nuk la ndonjë ditar. Po la shumë kujtime, që mbartin humorin e tij të hollë.

\*

Një ditë mjeku po bëhej gati për të dalë me të shoqen. Sa po bëheshin gati të zbrisnin shkallët, dëgjuan të trokitura në derë. Ishte një mikeshë e së shoqes që zakonisht vinte për të pirë ndonjë kafe dhe për të këmbyer ndonjë fjalë.

S'kishin ç' të bënin. U kthyen.

E shoqja e mjekut bëri qirasjen e zakonshme dhe vuri xhezvenë. Mikeshë e vuri re se burri i shoqes së saj po rrinte si mbi gjëmba. Si e piu kafënë, u ngrit për të dalë.

E shoqja zbriti bashkë me mikeshën e vet dhe mbeti te dera me muhabet. Ishte ky një zakon i keq i grave, që më tepër flisnin te pragu i derës, sesa kur ishin brenda në shtëpi. Dhe këtë zakon mjeku nuk e duronte dot, por s'kishte si t'i thoshte së shoqes për ta ndërprerë atë bisedë që dihej se kur nisi e që nuk dihej se kur do të


sa duroi, më në fund zbriti portën dhe iu drejtua të dyjave:

...ell ndonjë karrige se u lodhët në

...njëra tjetrën në sy.

...na vuri buzën në gaz dhe u largua. ...mjeku u çlirua dhe iu drejtua

...a të shkojmë për ku ishim nisur. ...erdhi edhe herë të tjera. Nuk i ...ndërhyrja e mjekut, por sa herë ...ndronte më te dera jo vetëm kur ...shtëpi, por edhe kur ndodhej ...kishte për të biseduar, i mbyllte ...kafesë.



\*

Ishim mbledhur në një sallë të madhe mbi bankën e vjetër ku zakonisht organizoheshin mbledhjet me mësuesit e rrethit (në ato vite ata nuk ishin shumë, as që e kalonin numrin 120).

Mjeku ynë ishte thirrur për të folur për masat parandaluese kundër gripit. Mbase e mbaroi fjalën e tij, ai mori të ikur.

Dikush e pyeti:

- Doktor, a lejohet përdorimi i rakisë kundër kësaj sëmundjeje?

Doktori nuk qëndroi, vetëm ngadalësoi hapat dhe e dha përgjigjen në ecje e sipër. Ai si theksoi dëmet e rakisë jo vetëm për këtë sëmundje, por edhe për sëmundje të tjera, kur mbërriti te pragu i derës, u kthye nga salla dhe iu drejtua të gjithëve:

- Veç, mos harroni, kur të pini, më thërrisni edhe mua.

Ky ishte mesazhi që mjeku dha në fund të leksionit të tij duke vënë buzën në gaz.

\*

Gjatë një konsulte për përcaktimin e diagnozës së një të sëmurit, mjeku ynë, si i dëgjoi mjekët e tjerë, nuk e dha mendimin e tij, por u largua dhe qëndroi para dritares dhe, për të mos i ofenduar shokët, filloi t'i fliste vetes:

- E di unë cila është diagnoza, e di unë...

(Dhe e përmendte emrin e diagnozës pa iu drejtuar askujt.)

Shokët edhe pse e dëgjuan qartë, nuk ia vunë veshin. Kur i sëmurit u keqësua, u dërgua në spitalin e Tiranës. Në Tiranë u dha po ajo diagnozë që kishte dhënë mjeku dhe që shokët e tij e kishin anashkaluar pa e vlerësuar.

- Si nuk ia vumë veshin, xhanëm?!- thanë kur mbetën si të turpëruar para mjekëve të Tiranës.

Që nga ajo ditë, kur e thërrisnin në konsulta, ia kërkonin mendimin dhe ia dëgjonin fjalën me vëmendje.

\*

Mjeku ishte i dhënë edhe pas shtypit. Herë-herë shkruante edhe vetë ndonjë artikull.

Atë ditë gazetën e priste me padurim.

Ndonjë nga shokët e tij, pasi ia lexonte shkrimin, për ta ngacmuar, i thoshte:


- Më kot mundohesh dhe shkruan, askush nuk ka për ta pëlqyer shkrimin tënd.

- Kur më pëlqen mua, nuk më bëhet vonë nëse e pëlqen apo nuk e pëlqen ndonjë tjetër si puna jote.


Dhe largohej me gazetën në dorë.

Agim Mehqemeja

# Faqja sportive



Përgatiti faqen sportive  
Vlash Pambuku



## FUTBOLL

### Punojmë, por frutet nuk po i marrim ne

Ekipi i paratërinjve me trajner Andrea Xheblati (majtas)

Janë fjalë që më tha ish-trajneri i futbollit (1977-1993) Andrea Xheblati, tashmë trajner i para të rinjve dhe fëmijëve në Berat.

Më kënaq puna që bëjmë, por më shqetëson e ardhmja e futbollistëve të vegjël. Më foli për punën e mirë që bën ai dhe kolegët e tij me ekipet e moshave. Ekipet stërviten në kushte të vështira. Në dimër fusha kthehet në gjol dhe në ditë vere dyndja e ekipeve vështirëson stërvitjen. Falë pasionit dhe talentit të fëmijëve që ne të përgatitim "kokrra" që do të piqen dhe të bëhen fruta për ekipin e të rriturve "Tomori", por ndodh ajo, si puna e frutave në pemë, që i rritim ne dhe i vjelin të tjerët. E kjo nuk është pak.

#### Përse ndodh kështu?

Ka disa arsye. Ka nënvlerësim për elementët që përgatitim ne e kjo vjen nga që ata i njohim pak. Ndonjë të metë të vogël të futbollistëve e trashin duke e bërë perin tra. Ka zvarritje me sot me nesër për ta afruar në ekip dhe kur e marrin e gozhdojnë në stol. Ka mani për të marrë futbollistë nëpërmjet merkatos që në disa raste është prirë nga emri se nga rendimenti aktual i tij.

Duke vepruar kështu kënaqësia jonë si trajnerë ka mbetur vetëm në faktin që kemi përgatitur një brez të mrekullueshëm larg veseve e rrugaçerisë.


#### Por çfarë ndodh me futbollistët cilësorë?

Disa nga ata i pushton pesimizmi aq sa arrijnë që ta braktisin futbollin, disa të tjerë bëjnë përpjekje të gjejnë ndonjë ekip tjetër oftë edhe jashtë shtetit të tierë me pak

pretendime luajnë në kategorinë e tretë. Përfundimisht, ekipi i të rriturve nuk i merr frutet e punës sonë.

#### Veçse disa kanë bërë emër

E di se për cilët e ke fjalën. Është e vërtetë portieri Durro dhe sulmuesi Veliq që luajnë me "Besën" janë titullarë të kësaj skuadre. Të mos harrohet se ne i përgatitëm. Cilido beratas kur i shikon apo dëgjon të flitet mirë për ta, ndien kënaqësi, e cila është krejt e natyrshme të përzihet edhe me një xheloz që e nxit sedra sportive, dëshmi e ndjenjës të



Trajneri Xheblati me ekipin e fëmijëve

patriotizmit qytetar. Dhe këtë ata e shprehin shpesh: "Ah sikur t'i kishim ne në Berat, nuk do të hallakatej aq futbollin ynë!"

#### Në Berat i kishim por...

- Çfarë por?- pyeta unë.

Nuk ditëm që t'i mbanim, t'i vlerësonim, t'i trajtonim ashtu si ata e meritonin. Largimi i tyre ishte mësim i mirë për futboll -klub "Tomorin" dhe bashkinë.

Ju them pa e tepruar,- vazhdoi Andrea,- se nuk janë vetëm këta, ka edhe të tjerë që kanë dalë nga ekipet tona që,

nëse do të luanin me ekipe të tjera, do të bënë jehonë.

#### Të kuptova Andrea, po si do të vejë kjo punë?

Shumë lehtë. Trajnerët e "Tomorit", stafi i shoqërisë aksionere duhet që ta kthejmë fytyrën e jo shpinën nga ekipet zinxhir, sepse ne për ta dhe vetëm për ta punojmë. Ata duhet të kujdesen për terrenet sportive, për vlerësimin e diferencuar të talenteve, stimulimin, gjë e cila do të bëjë që edhe interesimi për të blerë sa më shumë futbollistë të tjerë, sigurisht me këtë nuk dua të nënvlerësoj merkaton. E këto ç'ka fola më lart, përbëjnë edhe disa arsye përse nuk po ecën futbollin ynë.

#### Andrea, në cilën vend renditet ekipi juaj në kampionat?

Unë si trajner i moshave të vogla gjithmonë kam qenë i prirë në objektivin primar për të nxjerrë futbollistë sa më cilësorë (fruta), për t'i shijuar sportdashësi ynë që është i uritur për të parë talente të "Tomorit". Por duhet thënë,- foli Andrea,- se edhe rezultatit në tabelën e klasifikimit nuk e nënvlerësoj, sepse ajo është nxitëse, krijon optimizëm dhe këtë e duan më shumë ata që luajnë. Futbollistëve nuk do t'i pëlqente një renditje nga fundi i tabelës. Sigurisht se renditja e ekipit tonë në vendin e 5-të në kampionat kombëtar, i cili vlerësohet si një kampionat i fortë e cilësorë, kuptohet që kemi një ekip me elemente cilësorë (kokrra), që duhet t'i vjelin vetëm ne.

Me të drejtë sportdashësit,- përfudnoi bisedën e tij specialisti Xheblati,- sytë i kanë nga ne, shpesh na thonë, se çfarë mielli po gatoni. Mielli është i mirë, themi, por duhet të dinë turixhinjtë që ta pjekin.

- Keni të drejtë, z. Andrea!

### Boksieri me të ardhme


Në vitin 1962 shefi i klubit sportiv "Tomori" shkruante në gazetën "Zëri i rinisë" për rezultatet e mira dhe perspektivën që kishte ekipi i boksit "Tomori".

Ja disa nga mendimet e shefit Polizoi Buda:

"Ekipi i boksit stërvitet në qendër jo të përshtatshme, por në saj të pasionit dhe

të sakrificave boksierët arritën rezultate. Meritë kanë edhe trajnerët Murat Hoxha, Bujar Orizaj, Haki Caka, Ali Shënepremte.

Në ekipin e "Tomorit" ndër të tjerë do të veçoj edhe Virgjil Konomi, Jonuz Saraçi, Ylmi Dudushi, Edmond Mançi... Shkurtimisht disa cilësi pozitive të boksierit Mançi. Është boksier i talentuar, me forcë goditëse që shfaqet në ndërrerje, i saktë, kurajoz dhe me ren... boksier... boksier... do të b... shqipta... ushqim...



## Kam mall të shikoj gjyqtarë të Beratit në gjykime

Kur shikoj ndeshje të superligës apo të kategorisë së parë ku luan edhe "Tomori", që gjykohen nga gjyqtarë të qyteteve të tjera të vendit, madje edhe nga ato qytete të vogla që nuk kanë patur tradita, të them të drejtën sedra sportive për qytetin tim më nxit dëshirën për të parë gjyqtarë nga qyteti im. Dhe ashtu si unë, kam mendimin se këtë dëshirë do ta kenë edhe sportdashësit beratas.

Vite më parë, më kujtohet, që kishim një kolegji gjyqtarësh cilësorë që mbante peshë dhe jepte kontribut në ecurinë e futbollit shqiptar. Ndodhte që një të diel nga kolegji i gjyqtarëve të Beratit gjykohehin 3 ndeshje (pra 9 gjyqtarë, sa

gjysma e pjesëtarëve të kolegjiut), e kjo nuk ka qenë pak.

Dëshira për të pasur gjyqtarë cilësorë të Beratit vijën edhe nga një qëllim që ka lidhje me vlerat, kontributin e Beratit në futbollin shqiptar, ndaj kolegjiut të gjyqtarëve të Beratit në futbollin shqiptar, ndaj

kolegjiut të gjyqtarëve të Beratit duhet t'i jepet ndihmesë nga futboll-klub "Tomori", bashkia e FSHF-së me qëllim që të eci në traditat, sepse aktualisht përbërja e kolegjiut ka të rinj me të ardhme që duhen vlerësuar e stimuluar. Nëse në të ardhme do t'i krijohen kushtet këtij kolegjiut, të jemi të sigurtë se së shpejti do të shikojmë gjyqtarë e Beratit të drejtojnë takime të rëndësishme dhe pse jo ndërkombëtare, ashtu si ka qenë edhe tadita jonë.

### Karrige për Bar- Restorante

**C  
i  
l  
ë  
s  
i**

tel: 036220295

Vlash Pambuku

**PREKNI TE ARDHMEN**  
Drejtor Ilir Qepa

ADRESA:  
AGJENSIA E AUTOBUZAVE  
PERBALLE XHAMISE SE PLUMBIT.

## FIRMA "DAED"

Ndërton në Berat, Durrës, Sarandë

**BERAT:** Pallat me 8 kate, apartament me sipërfaqe 160m<sup>2</sup> pranë xhamisë në Çelepias, okazion, çmime tepër të arsyeshme.

**DURRËS:** Pallat me 5 kate ( shtëpi pushimi komode 1+1), te Shkëmbi i Kavajës, vija e parë buzë detit.

**SARANDË:** Pallat me 5 kate( 1+1) pranë Disko "Mango"-s

tel: 0692063390 - 0692063392